



www.fqurani.com

KËSHILLA

Përmbajtja/ Gusht 2011 (Nr. 41)

Do të lexoni:

-  **Bazat e edukimit të një shoqërie të shëndoshë** 8
-  **Thuajini njerëzve fjalë të mira!** 13
-  **Si ndërton Kur'ani paqe te njeriu dhe shoqëria?** 17
-  **Ndjenja e turpits e largon njeriun nga gabimet** 19
-  **Fjalë të urta arabe
e të tjera...** 25

Rubrika për fëmijë "Selam" përmban: **"Profeti dhe melekët", "Dy vëllezërit", "Kujtimet e mia", "Rrobat e reja"** e të tjera...

KËSHILLA

Nr. 41, Gusht, 2011
Organ i Fondacionit të Kur'anit

Drejtor:
Prof. Muhammed Reza
HAXH KHEZR

Kryeredaktore:
Liseda RAMAJ

Drejtor artistik:
Vullnet MERJA

Korrektori:
Vjollca KARAJ (FEZA)

Design & Layout:
Aurora SHEHU

Bashkëpunëtorë:
Vullnet MERJA
Vjollca KARAJ (FEZA)
Sabrie FEZA
Selim STAJA
Majlinda NDRECA
Jefmir CELA etj.

Përgjegjëse për rubrikën
"Selam": Mina Mekami
Bashkëpunëtorë:
Rejhane Ikbali
Fatime Haxh Khezer
Mina Mekami
Sabrie Feza

Adresa: Rr. Hoxha Tahsim Nr. 168
Kutia Postare: 8272
Tel & Fax: 00355 04 -2 377 311
Tirana – Albania
WebSite: www.fqurani.com
E-mail: f_quran114@yahoo.com



Me emrin e All'llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

I Dërguari i Allahut ka thënë:
"Xheneti zbukurohet e stoliset
çdo vit për Ramazan, thotë
Allahu im!" dhe "Ramazani
është muaj i sabrit (durimit),
e shpërblimi për sabër është
vetëm Xheneti. Le të bëhemi
në këtë muaj kujdestarë të
nderit, lexues të vazhdueshëm
të Kur'anit, luftues të imoralitetit,
krenarë me fenë tonë, të lartë
në dinjitetin tonë, mbrojtës të
moralit të pastër, mospërfillës
ndaj atyre që ftojnë për gjëra
të ndyra e të dëmshme, të
largohemi nga shembulli i
jobesimtarëve dhe imoralëve,
të bëhemi respektues ndaj
prindërve, familjes dhe
shoqërisë, të hapim një faqe të
re dhe të pastër të besëlidhjes
me Allahun, ta mbulojmë
e ta harrojmë të kaluarën,
t'i kthehemi me shpresë së
ardhmes e të pendohemi tek
Allahu, i Cili është Pranues
i pendimit dhe Falës i çdo
gjynahi.

Kryeredaktorja



R a m a d a n K a r e e m

Me emrin e All'lahut, Zotit të Muajit të Ramazanit!

Muaji i bekuar i Ramazanit erdhi.

Është muaji i zbritjes së Kur'anit.

Muaji, në të cilin ndodhet Nata e Kadrit, më e mirë se një mijë muaj.

Muaji, për të cilin, shpërblimi në këtë jetë është shërim për trupin dhe në Jetën Tjetër shogërimi me të mirët.

Muaji, në të cilin, uria dhe etja të kujtojnë të varfrit në këtë jetë si dhe urinë dhe etjen në Jetën Tjetër.

Muaji i pastrimit të zemrave, i shëndetit të trupit dhe i fluturimit të shpirtit.

Muaji, në të cilin ushqimet e sofrës së tij janë dritë dhe udhëzim. Nga ky ushqim arrijmë të dallojmë të vërtetën nga e pavërteta.

Muaji në të cilin jemi të ftuar në Mikpritjen e All'lahut.

Muaji i mikpritjes!

Ju urojmë gëzuar Muajin e Mikëpritjes së All'lahut! All'lahu ua lehtësoftë agjërimin dhe ju shpërbleftë me të mira!

*Prof. Muhammed Reza HAXH KHEZR
Drejtor i Fondacionit të Kur'anit*

Ramazani

muaji i mëshirës, i faljes dhe i mbrojtjes nga zjarri i Xhehenemit



Mirë se erdhe Ramazan! Mirë se erdhe, o muaj i Kur'anit! Mirë se erdhe, o muaj i mëshirës, muaj i pendimit, i faljes e i durimit, muaj i mirësisë dhe i solidaritetit gjithëmysliman, muaj i lutjes e i namazit, muaj i shpëtimit nga zjarri i Xhehenemit. Ardhja e Ramazanit është një rast i mirë. Fillimi i tij për ne është mëshirë. Mesi i Ramazanit, është falje e gjynaheve dhe dhjetëditëshi i fundit i muajit të agjërimit është mbrojtje nga zjarri në Ditën e Gjykimit.



Falënderimi i takon Allahut të Madhëruar, i Cili na udhëzoi për bamirësi, na dhuroi Librin e Tij-Kur'anin udhëzues për të gjithë ata që dëshirojnë të udhëzohen në rrugën e drejtë. Paqja dhe lavdërimet qofshin mbi të Dërguarin, të cilit Allahu ia zbriti Kur'anin në këtë muaj, mbi familjen dhe shokët e tij dhe mbi të gjithë ata që e ndjekin rrugën e tij deri në Ditën e Gjykimit. Trokitja në derë e këtij mysafiri të nderuar është një sihariq i mirë për të gjithë myslimanët. Zemrat e të devotshmëve lakmojnë mirësitë dhe begatitë e Krijuesit. Allahu thotë: ***"Muaji i Ramazanit është ai në të cilin ka zbritur Kur'ani, udhërrëfyes për njerëzit, sqarues i rrugës së drejtë dhe dallues (i së vërtetës nga gënjeshtra)."*** ("El-Bekare", 185)

Vlera e këtij muaji të madhërishtëm është shumë e madhe, kurse dobittë e agjërimit janë të panumërta. I Dërguari i Allahut ka thënë: *"Ky është muaj i sabrit (durimit), e shpërblimi për sabër është vetëm Xheneti. Ky është muaj në të cilin shtohet furnizimi i besimtarit. Ai që i jep iftar një agjëruesi, është shpagim për gjynahet që ka bërë, e largon nga vetja zjarrin e Xhehenemit dhe e ka shpërblimin e njëjtë me agjëruesin pa i pakësuar asgjë nga shpërblimi agjëruesit."* Agjërimi i këtij muaji mundëson pastrimin shpirtëror dhe faljen e gabimeve të vogla duke marrë parasysh fjalët e Profetit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!): *"Pesë kohët e namazit, xhumaja deri në xhuma dhe Ramazani deri në Ramazan i shlyejnë gjynahet e bëra në mes tyre, në qoftë se largohet nga gjynahet e mëdha."* Allahu i ka dhënë njeriut rastin ideal që ai të pastrohet nga gjynahet pesë herë në ditë, e më pas, atë javor në ditën e xhumasë dhe në fund, atë vjetor me agjërimit dhe namaz. Agjërimi bëhet vetëm për hir të Zotit Fuqiplotë, larg mendjemadhësisë dhe syve të njerëzve. Po ashtu, Allahu ka bërë që për agjëruesit të jetë një derë e veçantë e Xhenetit që quhet "Rejan" në të cilën do të hyjnë vetëm agjëruesit. Profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: *"Kush prej jush agjëron, atëherë le të agjërojë edhe veshët, sytë dhe gjuha nga gënjeshttrat e gjërat e tjera të ndaluara. Largohu nga dëmtimi i fqinjit. Në ty le të vërehet agjërimi dhe dita e agjërimit tënd të mos jetë si dita kur nuk agjëron."* Në këtë muaj besimtarët e ndershëm i përvjelin krahët për ta respektuar Allahun, duke lexuar Kur'an me meditim, frikë e respekt, duke shtuar bamirësinë ndaj prindërve, duke u sjellë me dashuri e dhembshuri ndaj tyre, duke u sjellë mirë me gruan, fëmijët e familjen dhe mbarë farefisin, duke i udhëzuar ata me fjalë të mira, duke u dhënë sadaka nevojtarëve, qofshin ata të afërt, fqinj apo të largët, sepse kështu kanë vepruar myslimanët e mirë gjatë këtij muaji. Profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: *"Agjërimi dhe Kur'ani do të ndërmjetësojnë për besimtarin në Ditën e Kiametit. Agjërimi do të thotë: 'O Zot! Unë agjëruesin e pengova ditën nga të ngrënë, të pirët dhe nevojat e tjera të ndryshme, pranoma ndërmjetësimin për faljen e tij!'" Edhe Kur'ani kështu do të thotë: 'O Zot! Unë kënduesin e pengova natën nga gjumi dhe pushimi, jepmë leje të ndërhyj për faljen e tij!'" Pas pranimit të këtyre lutjeve, të agjërimit dhe*

të Kur'anit, do të pranohet ndërhyrja e tyre në favor të besimtarit". Në agimin e hershëm të mëngjesit, në kohën e syfyrit, mëshira e Allahut zbret në qiellin e dynjasë dhe thotë: "A ka njeri që më lutet, që t'i përgjigjem?", prandaj, të mos e privojmë veten nga këto dhunti të mëdha hyjnore, por të lutemi, se ndoshta Allahu na përfshin me mëshirën e Ramazanit, na i fal gjynahet dhe dalim nga ky muaj të shpëtuar nga zjarri i Xhehenemit. Agjërimi bën të njihet vlera e mirëfilltë e veprave të mira. Ai zgjon ndjenjën e falënderimit, krijon vetëdijen për ta kuptuar hallin e të vuajturve, ndarjen e dhimbjes dhe vuajtjes me ata duke zgjatur dorën e dashurisë dhe të ndihmës drejt tyre me zekat dhe sadaka. Në këtë mënyrë, edhe njerëzit e vetmuar e të varfër bëhen të lumtur. Muhamedi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: "Xheneti zbukurohet e stoliset çdo vit për Ramazan, thotë Allahu im!". Le të bëhemi në këtë muaj kujdestarë të nderit, lexues të vazhdueshëm të Kur'anit, luftues të imoralitetit, krenarë me fenë tonë, të lartë në dinjitetin tonë, mbrojtës të moralit të pastër, mospërfillës ndaj atyre që ftojnë për gjëra të ndyra e të dëmshme, të largohemi nga shembulli i jobesimtarëve dhe imoralëve, të bëhemi respektues ndaj prindërve, familjes dhe shoqërisë, të hapim një faqe të re dhe të pastër të besëlidhjes me Allahun, ta mbulojmë e ta harrojmë të kaluarën, t'i kthehemi me shpresë së ardhmes e të pendohemi tek Allahu, i Cili është Pranues i pendimit dhe Falës i çdo gjynahi.

Ku janë kënaqësitë e kësaj bote?

Shkuan dhe nuk lanë gjëjetër,
përveç pendimit. Vallë, a mos je
ti ai njeri që nuk ke nevojë për
Zotin tënd? Apo ndoshta ke
harruar se tek Ai është
përfundimi yt? Të ka mahnitur
jeta e
kësaj bote? Të jesh i vetëdijshëm
se jeta e kësaj bote është
kalimtare dhe e
shkurtër, ndërsa jeta e Ahiretit
është e përhershme dhe e gjatë.
Ti e di se
kënaqësitë e kësaj bote janë
të kufizuara, ndërsa dënimi i
varrit është i
dhembshëm.

Besimtar/e i/e dashur, a ke
vendosur t'i kthehesh Zotit
tënd? Pse je zhytur në gjynahe?
Apo dhuntitë e shumta të
Allahut të kanë mashtruar? A
mendohet se je krijuar vetëm për
t'u dëfryer? Kush të ushqen,
nëse Ai të braktis? Kush të

furnizon, nëse Ai ta ndal furnizimin? Kush të ndihmon dhe të shpëton përveç Atij?

Kush të zbukuroi? Kush të gëzoi dhe të bëri të lumtur? Vetëm Allahu i ka këto mundësi dhe askush tjetër përveç Tij. Allahu nuk do që robin e Tij ta shohë në zjarr. Allahu është më i mëshirshëm për ty sesa nëna jote. Për këtë, eja dhe pendohu tek Zoti yt se nuk gjen Mëshirues tjetër, përveç Tij.



Përpunoi: Liseda Ramaj



Bazat e edukimit të një shoqërie të shëndoshë

Sot, kur të gjitha vlerat njerëzore, pra, edhe ato fetare, janë lëkundur, ku edhe vlerat e institucionit të familjes islame nuk janë kursyer, shprehet nevojë e madhe që vlerat e familjes të ruhen, që jeta familjare të kthehet në rrugën e saj të vërtetë, që këtij institucioni hyjnor t'i jepet forma e duhur. Synimi drejt jetës së lirë e pa brenga, ikja nga jeta familjare, është karakteristikë e kohës e cila e ka përfshirë njeriun e sotëm.

● Familja, institucion hyjnor

Për familjen janë dhënë përcaktime të shumta dhe ato ndryshojnë prej njëra - tjetrës. Një prej përcaktimeve më të përhapura e trajton familjen si një grup personash të lidhur nga gjaku dhe martesat, të cilët jetojnë bashkë për periudha të gjata kohore, ku pjesëtarët e moshës madhore kanë përgjegjësinë për rritjen dhe edukimin e fëmijëve.

Familja, sipas Islamit, është institucion hyjnor, origjina e së cilës rrjedh që me krijimin e njeriut të parë dhe ka për qëllim që njeriut t'i mundësojë veprime normale. Njerëzimi është produkt i institucionit të familjes e jo institucioni produkt i racës njerëzore. Familja myslimane përbën bërthamën e bashkësisë së pastër e të mbarë.

Kështu, mbarësia e individit është e lidhur kryekëput me mbarësinë e familjes, madje

edhe mbarësia e bashkësisë (shoqërisë) varet nga mbarësia e familjes. Për këtë, feja islame i kushton një interesim dhe rëndësi të dorës së parë çështjes së familjes e gjithçka që ka të bëjë me të, sikurse bazat mbi të cilat duhet ngritur, shkaqet e vazhdimësisë në ruajtjen e lidhjeve dhe kompaktësia në të, me qëllim që familja myslimane të mbetet e konsoliduar dhe e mbrujtur vazhdimisht me frymën e dashurisë, mëshirës e të mirëkuptimit. Kur`ani e ka bërë mëse të qartë se si burri, ashtu dhe gruaja janë të domosdoshëm për njëri-tjetrin. Lidhur me këtë Allahu Fuqiplotë në Librin e Tij thotë:

“O ju njerëz! Kini frikë Zotin tuaj, që ju ka krijuar prej një veteje dhe nga ajo krijoi palën e saj dhe prej atyre dyve, u shtuan shumë burra e gra”. Nga vetë fjalët e ajetit kuptohet se Allahu prej të njëjtit lloj krijoi burrin dhe gruan dhe në të njëjtën kohë deklaroi qëllimin e krijimit të kësaj qenie të veçantë, të cilës dot’ia besojë sundimin e botës. Në Fenë islame thuhet se nuk ka marrëdhënie më të natyrshme se ato të gjakut dhe se nuk ka shembull më të mirë të intimitetit seksual, përveç atij ku gërshetohen morali dhe kënaqësia. Feja islame e pranon vetëm mënyrën familjare të jetesës. Vlera dhe rëndësia më e madhe e familjes qëndron në faktin se ajo është institucion i shenjtë. Fatkeqësisht, sot institucioni i familjes është duke u rrezikuar nga një lloj i krizës së qytetërimit tonë.

Të gjitha simptomat tregojnë se kjo krizë e ka dëmtuar institucionin e familjes dhe në mënyrë të posaçme e ka dobësuar. Ajo gjendet në shkatërrim si në Evropë, ashtu edhe në Amerikë. Kjo gjendje duhet të shërbejë si sinjal dhe ta zgjojë njeriun bashkëkohor për ta mbrojtur institucionin e familjes dhe vlerat e saj. Duke e konsideruar njeriun të lirë për të zgjedhur mënyrën e tij të jetesës, ku burri dhe gruaja mund të jetojnë pa njëri-tjetrin,

me disa gra apo me disa burra, fëmijëve të lindur nuk u dihet me saktësi atësia dhe një pjesë e tyre ngel nën kujdesin dhe kontrollin e shtetit. Në të tilla raste bie përgjegjësia e prindit për fëmijët. Institucioni i familjes në Islam është i shenjtë dhe, si të tillë, kapërcaktuar konceptet e përgjithshme që duhet t’i përmbushë familja si bazë themelimi e një strukture shoqërore, fetare dhe kulturore. Lartësimi shpirtëror, edukimi moral, përmbajtja ndaj emocioneve dhe epsheve shthurëse, sjellja e mirë ndaj gruas/burrit, detyrat ndaj familjes dhe fëmijëve, kanë qenë ndër kriteret e detyrueshme për njeriun në Islam.

● Roli i familjes në edukimin e brezit të ri

Pasqyrimi i gjendjes së njerëzimit na bën të shohim se familja është institucioni i parë dhe më i rëndësishmi midis institucioneve sociale, si dhe forma më e hershme e shoqërisë njerëzore, e që është rezultat i vetë martesës. Brenda familjes fëmijët lindin jo vetëm si qenie biologjike, por edhe si anëtarë të një shoqërie të caktuar. Familja është shkolla e parë ku formohen njerëzit dhe qytetarët e ardhshëm, prandaj detyra e saj është të përgatisë dhe të risë pasardhës në frymën dhe sipas porosive të Krijuesit të gjithësisë, sipas edukatës islame, me qëllim që fëmijët e tyre të bëhen shkolla më të mira në përgatitjen e fëmijëve të tyre për jetë familjare e shoqërore. Kjo kërkon që problemi i edukatës të mbështetet në kultivimin e ndjenjave fisnike, në kultivimin e disiplinës, në formimin e shprehive të kultivuara higjienike, në veprimtari të dobishme, në raporte të drejta midis dy gjinive, në humanizimin e marrëdhënieve ndërnjerëzore etj. Si metodë kryesore e prindërve për edukimin e fëmijëve me mendime, shije e norma të shëndosha morale, shërben në radhë të parë shembulli personal, mënyra e jetesës dhe e sjelljes së prindërve, zakonet, rrethi dhe

ambienti, karakteri dhe ndikimi i të rriturve. Fëmija janë gëzimi dhe lumturia më e madhe e prindërve, sepse në to shihet vazhdimi i ekzistimit vetjak. Nuk mjafton vetëm të kesh fëmijë, të ndiesh kënaqësi për ta dhe t'i duash, por duhet t'i dish detyrat ndaj fëmijëve. Edukimi i fëmijëve është obligimi kryesor, sepse nga edukimi i mirë varet fati dhe përparimi i individit dhe i mbarë njerëzimit. Që prindi të arrijë t'i edukojë fëmijët e tij me sukses, duhet që vetë të jetë i kompletuar me edukatë të shëndoshë dhe shembullore. Kjo do të thotë se çdo prind është përgjegjës

Qëllimi është që, para së gjithash, deri te veshi t'i arrijë fjala e mirë dhe emri i Zotit. Obligohet prindi që, me kalimin e ditës së shtatë, fëmijës t'i japë një emër të bukur, kuptimplotë dhe të pëlqyeshëm. Për të pasur fëmijë me shije të lartë dhe edukatë të shëndoshë, duhet që fëmijëve t'u mësohet feja e vërtetë, fryma e moralit islam, si dhe parimet themelore të tij. Për të përfituar fëmijë me edukatë të shëndoshë, ndikon qumështi i nënës me moral të mirë e që jeton në mënyrë të ndershme. Fëmija që ushqehet me qumësht haram, prishet nga natyra morale dhe fiton



për fëmijët e vet. Për t'u plotësuar funksioni i vërtetë i familjes, prej prindërve kërkohet që ta përqendrojnë vëmendjen në këto pika: Është detyrë fetare që prindi foshnjës së porsalindur t'ia lexojë ezanin në vesh.

prirje për cilësi negative. Prindi duhet të ketë kujdes në pastërtinë fizike e morale të fëmijës, që tek ai të nguliten ndjenjat e personalitetit, dashurisë, mirëkuptimit, mirësjelljes dhe tolerancës.

Fëmija duhet mësuar që të mos ngutet gjatë ushqimit, të mos e mbushë gojën plot, të përtypë ushqimin mirë dhe të mos hajë tepër. Prindi është i obliguar që fëmijëve t'ua sigurojë nevojën materiale, ndërsa nëna të kujdeset për mirëqenien trupore. Pra, familja myslimane është përgjegjëse para Allahut sa i përket edukimit të fëmijëve. Lind pyetja: Vallë, a po e kryejnë familjet tona sot atë që u ngarkohet në përcjelljen e mesazhit edukativ të fëmijët?

frymën fetare, pa dyshim edhe fëmijët, në emër të Zotit do të kujdesen për ta.

● Familja në shërbim të mbrojtjes së moralit

Familja është fusha më e rëndësishme dhe institucioni i vetëm i cili mundëson jetë të shëndoshë, mbron bashkëshortët nga jeta imorale, shfrenimi, konfuziteti dhe siguron

A mbliiden pjesëtarët e familjes rreth sofrës kur'anore, apo rreth asaj të gjynaheve? Vallë, fëmijët tanë a gjejnë në familje atë që është e dobishme, e mbarë dhe e mirë për ta, apo gjejnë diçka tjetër? Është për të ardhur keq se sot shumë familje i kanë harruar të drejtat dhe detyrat që kanë ndaj fëmijëve të tyre. P.sh., është ulur kujdesi për ruajtjen e moralit të fëmijëve, dominon një liri e pakufizuar, nuk kërkohet llogari,



e për rrjedhojë sot shumë të rinj e të reja përdorin alkoolin, drogën dhe merren me prostitucion etj. Në këtë mënyrë nuk i pritet rruga këtyre veseve të liga të cilat degjenerojnë rininë, e më vonë familjen, e cila në të tilla kushte nuk ka bazë reale. Të çudit fakti se, në disa raste ka prindër që interesohen më shumë për pasurimin e fëmijëve, pajtohen deri me dërgimin e vajzave të tyre prostituta, për të siguruar jetën e tyre materiale. Cila është më e rëndësishme në këto raste, pasuria apo fëmija? Sigurisht, fëmija është më i rëndësishëm dhe kur prindi kujdeset për fëmijët e tij dhe i edukon me

klime të përshtatshme për zhvillimin e potencialit shpirtëror të burrit dhe të gruas, si dhe të pastërtisë morale. Familja si pjesë e rendit shoqëror duhet të karakterizohet nga një sjellje e përkryer mes individëve, për t'ia prerë rrugën shkatërrimit të saj. Imoraliteti konsiderohet si një krim, me pasoja shkatërruese për familjen dhe shoqërinë. Ish-presidenti amerikan John Cennedi lidhur me rininë amerikane ka deklaruar: "Rinia amerikane është në rrezik të madh nga imoraliteti. Në shtatë të rekrutuar për ushtri, gjashtë janë të paaftë, për shkak se kanë bërë jetë të shturur dhe kështu kanë humbur zotësinë dhe aftësinë trupore dhe



Thuajini njerëzve fjalë të mira!

Allahu i Lartësuar i ka urdhëruar robtë e Vet që të zgjedhin shprehjet më të mira, fjalët më të bukura, kur bisedojnë me njëri-tjetrin, në mënyrë që të përhapet dashuria dhe miqësia mes tyre dhe të largohen shkaqet e shkëputjes së raporteve familjare dhe urrejtja. Allahu i Lartësuar thotë: **“E ti robve të Mi thuaju: “Le ta thonë atë që është më e mira, pse shejtani ndërsen mes tyre, e është e ditur se ai është armik i hapur i njeriut.”** (“Isra”, 53)

Abdurrahman Sadi thotë: “Allahu nga butësia e Tij ndaj robve të Vet i urdhëron ata të përdorin fjalët më të mira, të kenë moral të mirë, fjalë dhe vepra që janë motivuese për lumturinë në këtë dhe për në Botën Tjetër dhe ka thënë: “E ti robve të Mi thuaju: “Le ta thonë atë që është më e mira”, pra, ky është urdhër për çdo fjalë që të afron tek Allahu, si përmendja e Tij, urdhërimi për të mirë, ndalimi nga e keqja, fjalët e mira dhe të buta me krijesat, me të gjitha kategoritë dhe pozitat e tyre. Ndërsa nëse çështja sillet mes dy të mirave, atëherë besimtari detyrohet të zgjedhë më të mirën, nëse bashkimi i të dyjave është i pamundur. Fjala e mirë është shtytëse për çdo moral të mirë, vepër të mirë, sepse kush e zotëron gjuhën e vet, ka zotëruar çdo gjë. Ndërsa fjala e Allahut: “Pse shejtani ndërsen mes tyre,” do të thotë se ai mundohet të fusë mes robve përçarje dhe t’ua prishë fenë dhe dynjanë e tyre. Ilaçi i kësaj është të mos dëgjohen fjalë jo të mira, në të cilat i nxit shejtani, ngase ai konsiderohet si armik i vërtetë i tyre, prandaj duhet ta luftojnë atë në atë që i nxit: **“Djalli është armik i juaji, pra edhe ju konsiderojeni armik; ai e thërret grupin e vet, vetëm për t’i bërë banorë të Zjarrit.”** (“Fatir”, 6) Çdo fjalë është e ruajtur dhe e regjistruar.

Ky është një fakt që Kur'ani e ka rrënjësuar dhe e ka përmendur në disa vende, në mënyrë që njeriu të llogarisë veten dhe gjuhën e vet. Ai thotë: **“që ai të mos hedhë ndonjë fjalë e të mos jetë pranë tij përcjellësi i gatshëm.”** (“Kaf”, 18) Gjithashtu, Allahu i Madhëruar, kur flet për çifutët dhe fjalët e tyre, thotë: “Allahu ka dëgjuar fjalën e tyre që thanë: “Allahu është i varfër e ne jemi të pasur!” Ne do të shënojmë atë që thanë ata dhe që i mbytën Pejgamberët pa kurrfarë faji e do t’u themi: “Vuajeni mundimin e djegies së zjarrit.” (“Imran”, 181) Siç ka lajmëruar gjithashtu se melekët llogarisin dhe regjistrojnë çdo fjalë të njeriut: “A mendojnë se Ne nuk e dëgjojmë ndjenjën e fshehtë të tyre dhe bisedën midis tyre? Po, e dëgjojmë dhe të dërguarit tanë (engjëjt përcjellës), që janë pranë tyre, shkruajnë.” (“Zuhruf”, 80) Ajetet kur’anore në këtë drejtim janë të shumta, por qëllimi është vetëm tërheqja e vërejtjes për robtë, që të kenë kujdes nga ajo që thonë dhe se ajo regjistrohet ose në favor të tyre ose kundër tyre, prandaj njeriu duhet të kujdeset gjithmonë dhe në çdo gjendje në regjistrin e tij të regjistrohen vetëm të mira, që t’i gëzohet kësaj në Ditën e Gjykimit.



Islami i nxit njerëzit që t’i përzgjedhin fjalët e mira të cilat fusin gëzim tek njerëzit. Allahu i Lartësuar thotë: **“...dhe njerëzve u thoni fjalë të mira.”** (“Bekare”, 83) Allahu nuk u lejon robve të vet publikimin e shprehjeve të këqija, vetëm në raste të caktuara, si në rastin kur i është bërë padrejtësi. Ai thotë: **“Allahu nuk do publikimin e shprehjeve të këqija, përveç (publikimit) të atij që i është bërë padrejtësi. Allahu është Dëgjues, i Ditur.”** (“Nisa”, 148)

Të parët tanë i ushtronin gjuhët e tyre dhe kujdeseshin për zgjedhjen e shprehjeve dhe të fjalëve për të cilat nuk do të pendoheshin. Isai pa një ditë një derr dhe tha: “Kalo në paqe.” Atëherë i kanë thënë: “Këtë po i thua derrit?” U përgjigj: “Po e ushroj gjuhën time me fjalë të mira.” Njerëzit më të denjë që meritojnë që ti të sillesh me ta me këtë moral janë prindërit, për të cilët Allahu ka urdhëruar të jemi bamirës ndaj tyre. Allahu thotë: **“Zoti yt ka dhënë urdhër të prerë që të mos adhuronit tjetër përveç Tij, që të silleni në mënyrë bamirëse ndaj prindërve. Nëse njërin prej tyre ose që të dy i ka kapur**



pleqëria pranë kujdesit tënd, atëherë mos u thuaj atyre as “of - oh”, as mos ubëj i vrazhdë ndaj tyre, por thuaju fjalë të mira (të buta, respektuese)." ("Isra", 23)

Shumica e të parëve, kur flisnin me nënat e tyre, gati nuk u dëgjohej fare zëri nga kujdesi i madh i tyre që të ulnin zërin nga edukata e tyre. Disa prej tyre, kur kalonin pranë tyre, çdo ditë thoshin: "Zoti im! Mëshiroji ata të dy sikurse më edukuan mua kur isha i vogël." Kurse ne sot çuditemi nga gjendja e të rinjve dhe e të rejave se si sillen vrazhdë me prindërit e tyre, duke ngritur zërat, i qortojnë, i shajnë. Sikur një njeri të mos ketë njohuri se ata janë prindërit e tyre, do të mendonte se ata janë shërbëtorë që punojnë tek ata nga vrazhdsia e tepërt dhe nga fjalët që përdorin fëmijët me prindërit e tyre.



S'do mend se baza mbi të cilën duhen ndërtuar shtëpitë është mëshira dhe dashuria. Allahu thotë: *"Dhe nga faktet (e madhërisë) e Tij është që për të mirën tuaj, Ai krijoi nga vetë lloji juaj palën (gratë), që të gjeni prehje tek ato dhe në mes jush krijoi dashuri dhe mëshirë. Në këtë ka argumente për njerëzit që mendojnë."* ("Rum", 21) Bashkëshortët kanë nevojë të zgjedhin fjalët më të mira kur flasin me njëri-tjetrin dhe të shfaqin

dashurinë dhe mëshirën e ndërsjellë. Lexo këtë bisedë në mes të Dërguarit dhe nënës së besimtarëve, Aishes, kur i ka thënë asaj: "Unë di kur je e kënaqur me mua dhe kur je e hidhëruar me mua." Ajo e ka pyetur: Si e di këtë? Ai i ka thënë: "Kur je e kënaqur thua: Jo, pasha Zotin e Muhamedit, ndërsa kur je e hidhëruar thua: Jo, pasha Zotin e Ibrahimit." Aishja: "Po, është e vërtetë o i Dërguar i Allahut. Çfarë mëshire është kjo?!" Nevoja shtohet edhe më shumë për këtë moral të bukur në rastet e hidhërimit. Sa bukur i ka thënë Ebu Derda bashkëshortes së tij: "Nëse më sheh të hidhëruar, më kënaq dhe më qetëso, ndërsa nëse të shoh të hidhëruar, të qetësoj, ndryshe do të ndahemi." Kësisoj, vëllezër të nderuar, myslimani duhet ta ushtrojë gjuhën e vet që të flasë vetëm mirë. Allahu thotë: "Në shumë biseda të tyre të fshehta nuk ka kurrfarë dobie, përveç (bisedës) kush këshillon për lëmoshë, për ndonjë të mirë ose pajtim mes njerëzve. E, kush i bën këto duke pasur për qëllim vetëm kënaqësinë e Allahut, Ne do t'i japim më vonë (në Botën Tjetër) shpërblim të madh." ("Nisa", 114)

Rreziku i gjuhës

Me të vërtetë mosndreqja dhe moskontrollimi i gjuhës është një rrezik i madh për të cilin kanë ardhur shumë argumente nga Kur'ani dhe syneti i Pejgamberit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!).

Duhet ta dijmë secili se çdo fjalë e tij përcillet dhe shkruhet. Allahu i Lartësuar ka thënë: **"...kur dy engjëjt qëndrojnë pranë tij në të djathtë dhe në të majtë. Që ai nuk hedh ndonjë fjalë e të mos jetë pranë tij përcjellësi i gatshëm."** ("Kaf", 17-18)

Çdo fjalë që thotë njeriu është nën përcjelljen e melekëve, pra të kemi kujdes se çfarë flasim. Pejgamberi ka thënë: "Atij që e siguron atë që është në mes dy mjekrave dhe atë që është në mes dy këmbëve, unë do t'ia siguroj Xhenetin." (Buhariu 11/308.)

Fjala: "Ai që e siguron atë që është në mes dy mjekrave" ka për qëllim gjuhën, e cila gjendet mes mustaqeve dhe mjekrës, kurse fjala: "dhe atë që është në mes dy këmbëve" ka për qëllim organin gjenital. Ky hadith tregon për vlerën e ruajtjes së gjuhës. Atij që ka kujdes kur flet dhe e ruan gjuhën e tij nga fjalët e kota, Pejgamberi ia ka





Si ndërton Kur'ani paqe te njeriu dhe shoqëria?

Nocioni “paqe” (Es-Selam) nën dritën e Kur'anit

Duke studiuar kuptimin, nocionin e *pages* (es-selam) nën dritën e Kur'anit, do të arrijmë në një rezultat fenomenal dhe do të shohim veten dhe hapësirën që i është dhënë paqes, problemit të sotëm botëror. Krahas vetë indikacionit që dini, Islami e mban në emrin “*El-Islam*”, i cili është nxjerrë pikërisht nga rrënja e fjalës “es-selam”. Në Kur'an gjejmë më shumë se 140 terma të një rrënje të vetme me gjerat: *Sin*, *lam* dhe *mim*, pra e njëjta rrënjë që do të thotë: *Paqe, siguri, rehati, prehje...*

Idea kur'anore e *selam-it*, në kuptimin e përgjithshëm të tij, është themeluar në bazat e fesë, në domethënien e jetës së njeriut dhe rrethit të përgjithshëm ku ai vepron. *Selami*, të cilin e propagandon Islami është ai që është nxjerrë nga vetë thellësia e shpirtit dhe e mendjes së njeriut, duke u nisur nga individi, përmes familjes, deri te bashkësia dhe shteti në tërësi. Selami në fenë islame fillon prej shehadetit me të cilin manifestohet Njeshmëria e Zotit dhe krijimtaria unike e Tij: **“O njerëz! Frikësojuni Zotit tuaj, i Cili ju krijoi prej një njeriu të vetëm, e nga ai krijoi shumë meshkuj e femra!”** (“En-Nisa”, 1)

“Ne nuk kemi nisur asnjë të Dërguar para teje, e që të mos i kemi shpallur: “S’ka zot tjetër përveç Meje, prandaj më adhuroni (vetëm) Mua!” (“El-Enbija”, 25)
“O të dërguar! Hani nga të lejuarat dhe bëni vepra të mira! Vërtet, Unë e di mirë çfarë bëni ju! Vërtet, kjo feja juaj është një fê e vetme, ndërsa Unë jam Zoti juaj, prandaj frikësohuni prej Meje!” (“El-Mu’minun”, 51-52)

Pra, pasi që besojnë në Një Zot të Vetëm, njerëzit bëhen një ymet, me fê identike në

të cilën nuk pranohet asnjë ndarje në bazë të racës, kombit apo çfarëdo lloji të diferencës, përveç se në devotshmëri.

Qetësia në zemrën e individit - paqja shpirtërore

Nuk do të ketë paqe në botë derisa vetë individi nuk ndërton paqen në vetvete. Për këtë, Kur'ani, krahas dispozitave që rregullojnë raportet mes shteteve, krahas ajeteve të shumta që harmonizojnë raportet në bashkësi, vëmendje të veçantë i kushton qetësisë (paqes) shpirtërore të individit (es- selam er-ruhi). Ky *selam* shpirtëror (për të njëjtën ekziston term tjetër (selamu ed-damir) fillon bashkërisht me akiden e pastër - besimin islam, i cili ngulitet në zemrën e besimtarit ashtu siç nguliten themelet, tek të cilat, mbahet godina e madhe.

Mangësia apo problemi që mund t'i ndodhë bazës akaidologjike të individit, do të reflektojë negativisht në segmenetet e jetës, qoftë në njohjen e rolit të tij, në raportin joadekuat kundrejt kaderit dhe fatit, në shenjtëritë e paramenduara, apo në autoritetin të cilit i jep rëndësinë që nuk e meriton, por kjo është një temë e veçantë që kërkon më shumë hapësirë. Nga ana tjetër, problemi akaidologjik tek individi mund të jetë shkak që ai të dorëzohet para sprovave. A thua vallë shpirti i besimtarit mund të luhatet dhe të demoralizohet edhe krahas këtyre ajeteve:

“Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit! Pafsha Kohën! Me të vërtetë, njeriu është në humbje, përveç atyre që besojnë dhe bëjnë veptra të mira, i këshillojnë njëri-tjetrit të vërtetën e i këshillojnë njëri-tjetrit durimin.” (“El-Asr”, 1- 3)

Gjithashtu, akideja ndërton një personalitet islam që nuk është shumë i lidhur me stolitë e kësaj bote, e as që është i ngarkuar me ndalesa të pakufishme, por i është lejuar e mira dhe e këndshmja dhe i është ndaluar e shëmtuara dhe e urryera:

“Thuaj: ‘Kush i ka penguar stolitë dhe ushqimet e këndshme, të cilat Ai i ka krijuar për robtë e Vet? Thuaj: Ato janë për besimtarët (dhe të tjerët) në këtë botë, ndërsa në Botën Tjetër do të jenë vetëm për besimtarët. Kështu ua shpjegojmë shpalljet njerëzve që dinë. Thuaj: Me të vërtetë, Zoti im ka ndaluar vetëm punët e pahijshme, qofshin publike apo të fshehta dhe gjynahet, dhunimin pa të drejtë, t'i shoqërohet Allahut (në adhurim) diçka, për të cilën nuk ju ka dhënë kurrfarë të drejte dhe të thoni për Allahun atë që nuk e dini.” (“El-A'raf”, 32-32)

Dhe, vërtetë shumë njerëz pa akide të pastër dhe të qartë në gjithë veprimtarinë e tyre janë në një gjendje jo të ekuilibruar psikike, për shkak të lidhjes së pakontrolluar me stolitë e kësaj bote nga njëra anë dhe zhytjes së pashpresë në gjynahe nga ana tjetër. Kur'ani, ashtu siç është realist ndaj dëshirës së njeriut për gjërat e bukura nga ajeti i lartpërmendur, është realist edhe ndaj dobësisë së njeriut dhe mundësisë për të gabuar:

“Thuaj: “O robtë e Mi, që i keni bërë keq vetes me gjynahe, mos e humbni shpresën në mëshirën e Allahut! Allahu, me siguri, i fal të gjitha gjynahet. Vërtet, Ai është Falësi i madh dhe Mëshirëploti.” (“Ez- Zumer”, 53)

Kështu ndërtohet personaliteti islam, i cili me të vërtetat që e edukoi Kur'ani duhet të rrezatojë me qetësi dhe rehati, kuptohet nëse tekstet i ka kuptuar drejtë e u ka besuar me bindje të thellë, dhe po në të njëjtën kohë, i ka manifestuar në jetën e përditshme.

Nëse kjo ndodh, atëherë nuk ka kurrfarë fije dyshimi se një personalitet islam i tillë është i gatshëm për rolin tjetër që dini – Islam ia ka caktuar: formimin e familjes në themelet e paqes dhe të harmonisë.

Nedim Haraçiq

NDJENJA E **TURPIT** E LARGON NJERIUN NGA GABIMET

Përveç mësimi të turpit fëmijëve, nuk duhet ta neglizhojmë turpin që duhet të kemi ndaj Allahut. Më shumë duhet të kemi turp ndaj Allahut se nga njerëzit apo krijesat e tjera sepse Ai është Krijuesi ynë e Ai na sheh kudo që jemi, prandaj duhet të tregojmë shumë kujdes në çdo moment të jetës. Një ditë Ibn Omeri shkoi pranë një fëmije që po kulloste delet dhe i kërkoi t'i shiste një dele. Fëmija i tha se nuk mund ta shiste sepse delet nuk ishin të tijat. Ibn Omeri i tha: "Të zotit të deleve thuaji që e ka ngrënë ujku." e kështu paratë që do marrësh të ngelin në xhep. Fëmija i thotë: "Në rregull, atij do t'i them që e ka ngrënë ujku, por a e sheh Allahu këtë veprim? Përgjigja e fëmijës tregon haptas gradën e lartë të moralit që kishte fëmija.

Ndjenja e turpit e pengon njeriun nga punët e këqija. Pejgamberi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) thotë: "Nëse nuk ke turp, b ë j

çfarë të duash". Me këtë fjalë të Pejgamberit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) e kuptojmë shumë mirë se sa i ngulitur është turpi tek natyra e njeriut. Një nga shembujt më të mirë të turpit është te historia e Jusufit kur Zulejha'ja e mbyll në dhomë për t'u afruar me të dhe kishte mbuluar putin që kishte në dhomë. Kur Jusufi e sheh këtë, e pyet përse e kishte mbuluar putin? Më vjen turp nga ai i thotë Zulejhaja. Jusufi i thotë: "Kur ti ke turp nga një zot i rremë e si mendon ti se unë nuk kam turp nga Allahu, i Cili është Një dhe i Vërtetë?!".

Të mos harrojmë se sot, në këtë kohë kemi nevojë më shumë se asnjëherë për një rini të turpshme. Një i ri apo e re që ka turp, nuk ka nevojë për tërheqjen e vëmendjes si nga prindërit, ashtu edhe nga ligji. Turpi që ka ai ose ajo e re i mjafton për ta mbajtur larg të këqijave.

Ibn Abasi transmeton se Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: *“Çdo fe ka morale të veta e morali i Islamit është turpi.”*

Meqënëse Islami është feja e vetme e pranuar, Allahu i ka dhënë kësaj feje moralin me të lartë që është turpi. Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) na ka dhënë ne shembullin më të lartë në ndjenjën e turp. Ebu Said el Hudrij thotë se Profeti kishte më tepër turp se sa ka një virgjëreshë brenda dhomës së saj e nëse ai urrente diçka, kjo dukej në fytyrën e tij.

Janë të shumta hadithet që flasin për ndjenjën e turp dhe që qartësojnë pozitën e lartë të tij në Islam. Ebu Hurejre thotë se Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: *“Besimi është 70 e disa pjesë; më e mira prej tyre është fjala LA ILAHE IL ALLAH e më e ulëta është heqja e një pengese nga rruga. Turpi është prej besimit.”* Ibn Omeri thotë se Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) kaloi pranë një burri që po e këshillonte vëllain e tij dhe ai i tha atij: *“Lëre atë se vërtetë është prej besimit.”* Po ashtu, ai ka thënë: *“Turpi dhe besimi janë shokë së bashku dhe nëse ngrihet njëri prej tyre, ngrihet edhe tjetri.”* Ibn Mesudi transmeton prej Profetit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!): *“Prej gjërave të profetësisë së parë që kanë kapur njerëzit është: nëse nuk ke turp, bëj çfarë të duash.”*

Përkufizimi i turp

Kanë thënë:

1. Një moral që shtyn për kryerjen e një veprë të mirë ose për lënien e një veprë të urryer.

2. Shtrydhja e vetes për lënien e një gjëje të urryer.

Turpi është një karakteristikë e njeriut për të mos bërë çdo gjë që ai dëshiron, siç veprojnë kafshët. Ai është një moral fisnik e kujt i bëhet haram, atij i bëhet haram e tërë mirësia, e kush është pajisur me këtë virtyt, fiton krenarinë, respektin dhe merr tërë mirësinë. Turpi është një ndërtesë e vërtetë në natyrshmërinë e njeriut. E nëse sheh dikë që skuqet apo zihet ngushtë nga puna apo fjala që nuk duhet, dihet se ai është vërtetë i gjallë. E nëse sheh dikë tjetër që kur bën një vepër të keqe nuk i bëhet vonë, dije se tek ky person nuk ka mirësi.

TË NJIHEMI ME SURET E KUR'ANIT

24


Nur

Medinase

64 ajete

1316 fjalë

5680 shkronja



Emërtimi: Dritë, shkëlqim.

Shkaku i emërimit: Është ajeti 35 i kësaj sureje, "Zoti është dritë e qiejve dhe e tokës", i njohur ndryshe edhe si ajeti i dritës. (Në të vërtetë, kjo sure mund të konsiderohet edhe si surja e dëlirësisë dhe e luftës kundër moralit të fëlliqur.) Ndërkaq, në Kur'an, fjala "dritë" është përmendur 43 herë; vetëm në këtë sure është përmendur 7 herë, e vetëm në ajetin e dritës është përmendur 5 herë.

Emra të tjerë: Nuk ka.

Përmbajtja e sures

- Vendimi për ndëshkimin e ashpër të burrit imoral dhe gruas imorale
- Hadithi i njohur dhe fyerja që i është bërë njëres prej grave të Profetit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)

- Mëkati i madh i spekulimit ndaj njerëzve të pastër
- Urdhri për të mos e parë dikë me qëllim; as gruaja burrin dhe as burri gruan dhe përmbajtja e syrit nga gjynahi
- Mbulesa e gruas myslimane, moszbukurimi i saj dhe mosbërja e tualetit të fytyrës jashtë shtëpisë së saj
- Tërheqja e vërejtjes për mosrespektimin e mbulesës
- Martesa si një rrugë për të parandaluar imoralitetin dhe ruajtjen e një shoqërie të shëndoshë
- Edukata e fëmijëve
- Mënyra e jetesës familjare dhe hyrja në shtëpitë e të tjerëve
- Besimi në Një Zot, jeta në këtë botë, Dita e Ringjalljes dhe zbatimi i urdhrit të Profetit, që është dhe baza e të gjitha programeve praktike dhe morale (Besimi te feja e Zotit dhe bindja ndaj të Dërguarit të Tij)
- Pushteti universal i besimtarëve të drejtë

Renditja e sures

Sipas renditjes së tubimit, është surja e 23-të; sipas zbritjes, është surja e 102-të dhe ka zbritur para sures "Haxh" dhe pas sures "Nasr".

Historitë e sures: Musai (paqja qoftë mbi të!); ajetet 35-36; tregimi i shpifjes; ajetet 11-21;

Fillimi dhe fundi

Fillimi: "Kjo është sure, të cilën Ne e shpallëm dhe Ne e bëmë detyrim të domosdoshëm (zbatimin e dispozitave që theksohen në të) dhe Ne parashtruam në të argumente të qarta, që të merni mësim."

Fundi: "... Ai e di gjendjen tuaj (besimin apo dyfytërsinë), e ditën kur i kthehen Atij, Ai do t'u kallëzojë atyre atë që vepruan. Allahu di gjithçka."

Mirësia e sures

Imam Sadiku ka thënë: "Ruajeni pasurinë tuaj nga shpërdorimi dhe nderin tuaj nga turpërimi duke lexuar (a kënduar) suren "Nur" dhe ruajini gratë tuaja nga devijimet me anë të urdhrave të Zotit, dhe kush e lexon (a këndon) natën e ditën këtë sure, asnjë nga anëtarët e familjes së tij nuk do të turpërohet dhe nuk do të çnderohet".

NGA TA DIMË



Rejani: Si mund ta besojmë të vërtetën e atij që thotë se jam i dërguar i Zotit?

Amiri: Të vërtetën e tij e mësojmë prej dëshmisë së Allahut për të, njëlloj siç e mësojmë se një person thotë: unë jam përfaqësues i ministrit dhe me vete mban shkresë prej ministrit për t'i besuar thëniet e tij.

Rejani: Si e njohim dëshminë e Allahut për të Dërguarin?

Amiri: Prej firmës së Allahut për profecinë, ashtu siç dëshmojmë shkresën e përfaqësuesit me firmën e ministrit.

Rejani: Cila është firma e Allahut?

Amiri: Dhënia e mrekullive (mu'xhizetu).

Rejani: Ç'është mu'xhizeti?

Amiri: Mu'xhizeti është diçka e pamundur për njerëzit që të veprojnë të njëjtë me të.

Rejani: Më jep shembuj për mu'xhizetin:

Amiri: Prej mu'xhizetit është: ringjallja e të vdekurit, shërimi i të verbrit, përlulja e sendeve të ngurta...

Rejani: A janë të mundura këto gjëra?

Amiri: Po, ku është pengesa?

Rejani: Si është në gjendje njeriu t'i bëjë këto veprime?

Amiri: A beson se Allahu është i Fuqishëm për këto gjëra?

Rejani: Po, besoj.

Amiri: Përderisa Allahu është i Fuqishëm dhe do të dërgojë Profet, Ai ia jep këtë mu'xhizet atij Profeti me qëllim që njerëzit të besojnë në thënien e tij se ai është i Dërguari i Allahut.

Rejani: Këto janë thënie logjike. Por, a sollën të dërguarit mu'xhizat?

Amiri: Po.

Rejani: Më përmend disa prej tyre.

Amiri: Dora e bardhë, shkopi, çarja e detit. Këto ishin mrekulli të Musait.

Rejani: M'i sqaro ato më tepër.

Amiri: Musai, kur e fuste dorën në xhep dhe e nxirrte, ajo shkëlqente si drita e diellit. Ai ka pasur shkop i cili shndërrohej në gjarpër të madh që hante çdo gjë që shihte. Pastaj, kur e kapte, ai kthehej në shkop ashtu siç ishte në fillim. Ai dhe Beni Israilët deshën të kalonin Detin e Kuq; në det u hap rrugë kalimi për të kaluar Musai dhe Beni Israilët të cilët nuk kanë qenë më pak se gjysëm milioni. Ringjallja e të vdekurit, shërimi i të verbërve, krijimi i shpendëve prej balte dhe dhënia shpirt atyre, kanë qenë mu'xhizete për Isain.

Rejani: Isai ka qenë i aftë për ato gjëra?

Amiri: Po.

Rejani: Ku janë faktet lidhur me të, sepse ne nuk i kemi parë?

Amiri: Cilat janë faktet që tregojnë për popujt e shkuar siç janë babilijtë, keldanijtë, erijijtë...?

Rejani: Historitë e sakta.

Amiri: Fakt i atyre mu'xhezeteve janë historitë e sakta të cilat i përmendin këto mu'xhizete (mrekullira) dhe ne i besojmë ato edhe pse nuk i kemi parë. Informimi për çështje të ardhshme, burimi i ujit prej gjshtave, ngopja e shumicës me ushqim të pakët, çarja e hënës, Kur'ani etj., kanë qenë muxhizete (mrekullira) për Profetin Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!).

Rejani: Sqaroji më mirë!

Amiri: Profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) lajmëroi për çështje të ardhshme, siç kanë qenë: romakët do të thyhen, Ebu Lehebi nuk beson e të tjera lajme të cilat u realizuan, ashtu siç lajmëroi Profeti.

Prej gjshtave të tij buroi ujë prej të cilit pinë shumë njerëz (siç përmendet në histori). Ai ngopi shumë njerëz me ushqim të pakët (siç përmendet

në histori), çau hënën derisa u dukën dy gjysma në qiell. Atij i zbriti Kur'ani, i cili i bëri të paaftë të tjerët që të sillnin të ngjashëm me të. Të gjitha këto e me dhjetra e qindra të tjera, janë argumente të profetësisë së tij.

Rejani: Si mund të jenë të mundura këto mrekulli që përmende?

Amiri: Ato janë shumë të lehta për Allahun. Ku është pengesa që Allahu të krijonte dritë në dorën e Musait? Apo të krijonte gjarpër të madh prej shkopit të tij? Apo të largonte ujin prej vendit të tij?

Ku është pengesa që Ai të fuste shpirtin tek i vdekuri për Isain? Apo të shëronte të verbërin apo të sëmurin? Ku është pengesa që Allahu të lajmëronte Profetin Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) për çështje të ardhshme? Apo të krijonte ujë në gishtat e tij? Apo të krijonte ushqim mbi ushqim? Apo të çante hënën në dy pjesë dhe ta kthente siç ishte? Apo t'i shpallte atij fjalë që janë mbi fuqitë dhe fjalët e njerëzve?



Më mirë është të shpenzosh një qiri të vogël se sa tërë jetën ta kalosh në terr.

Gjithnjë derisa qëndron në këmbët e tua, mos vajto nëse nuk mundesh të vraposh.

“E mundura” pyet “Të pamundurën”: Ku jeton? Përgjigja: Në ëndrrat e të paafteve.

Shtëpia pa libra është shtëpi pa shpirt.

Nuk është i fortë ai që gjithnjë fiton luftrat, por i dobët është ai që gjithnjë e humb paqen.

Nëse do që të urrejnë të gjithë, thuaju të gjithëve se kush janë.

Epitetet janë shenjat e budallait dhe njerëzve të mëdhenj nuk u duhet asgjë më shumë se sa emri i tyre.

Kush e do një dru, do edhe degët e saj.

Mos e arrij paqen me luftë, por me marrëveshje.

Kur drejtësia zhduket nga faqja e dheut, njeriu bëhet i pavlefshëm.

Nuk është kënaqësi të punosh gjithnjë atë që dëshiron, por është kënaqësi kur e do punën që e dëshiron.

Turpi është bukuria e femrës, ndërsa vlerë te meshkujt.

Nëse digjet shtëpia e fqinjit, ruaje tënden.

Mik e ke atë që ta tërheq vërejtjen nga gabimet tua e jo ai që ta zbukuron gabimin tënd për t’u bërë më i dashur.

Miqësia është si pusi, sa më tepër nxjerr nga ajo, aq më e thellë bëhet. Buzëqeshja është fjalë e bukur pa shkronja.

Mos përkujto shumë atë çka e ke humbur për të mos e humbur atë çka e ke.

Fjala e mirë është pasaportë për të hyrë në çdo zemër.

Përktheu nga boshnjakishtja: Xhavit MAHOLLI

FJALË TË URTA ARABE

TREGUES I EMRAVE MYSLIMANË

Halit (Khàlid)	Halit, Lit, Lito	I përhershëm
Hamdi (Hamdij)	Hamdi	Falënderues
Hamid (Hamijd)	Hamid, Hamit, Mit, Pit	Falënderues me tërë kënaqësinë e shpirtit
Hamza (Hamzeh)	Hamza,	Luan
Hariz (Hàriz)	Hariz,	Ruajtës
Harun (Hàrùn)	Harun	Emri i profetit Harùn [paqja qoftë mbi të!], emër hebraik
Meleqe (Melekeh)	Meleqe, Leqe	Sunduese, zotëruese e diçkaje
Meliha (Melijhah)	Meliha, Meli	E lezetshme, gjithë kripë
Mereme (Merjem)	Mereme, Reme	Emri i nënës së profetit Isa [paqja qoftë mbi të!], emër hebraik
Mersije (Mersij'jeh)	Mesije	Vazhdimësi
Metije (Metij'jeh)	Metije, Tije	Lëvizëse me hapa të matura
Mevlude (Meulùdeh)	Mevlude, Lude	E lindur; emër që i vihet vajzës së lindur në hënën e Mevludit

H. Selim Stafa



Mes dy shokëve

Arbri: A e di Zoti zullumin e zullumqarëve?

Albani: Po, e di.

Arbri: A mund t'i pengojë ata prej zullumit?

Albani: Po, mundet.

Arbri: A e urren zullumin e tyre?

Albani: Po, e urren.

Arbri: Përse nuk i ndalon ata prej zullullumit?

Albani: Allahu e ka krijuar njeriun dhe në të ka vendosur dëshirën dhe zgjedhjen. E ka urdhëruar atë për përfundimin ndaj Tij dhe për të vepruar hajër dhe e ka ndaluar prej mëkateve dhe sherrit. Nëse vepron të mira, shpërblimi i tij do të jetë i mire, qoftë në këtë jetë apo në jetën tjetër (Ahiret). Dhe nëse vepron të këqija, shpërblimi i tij do të jetë i keq. Në qoftë se njeriu do ishte i detyruar në veprat e tij, nuk do kishte dallim në mes tij dhe sendeve të ngurta dhe në këtë mënyrë, nuk do ketë plotësim e as prodhim për njeriun.

Arbri: Cili do të jetë përfundimi i atyre që iu bë zullum (padrejtësi).

Albani: Ai do të shpërblehet me të mira dhe të pëlqyeshme.

Arbri: Ku do e gjejë këtë shpërblim?

Albani: Në këtë jetë dhe në Jetën Tjetër.

Arbri: Çfarë janë fatkeqësitë që e prekin njeriun?

Albani: Ato janë ose pastrim i njeriut prej gjynaheve, ose dënim për çka veptoi, ose krenari për të në Ahiret.

Marrë nga: "A dëshiron ta njohësh Allahun?"

Gjethja e ullirit kundër obezitetit



Studiuesit theksojnë se një filxhan kafeje i përgatitur vetëm me esencën e gjethes së ullirit të ndihmon në luftën kundër obezitetit. Sipas lajmit të publikuar nga gazeta "Sydney Morning Herald", studimi i bërë në Universitetin Southern Queensland's përfshin minjtë e ushqyer për tetë javë rresht me një dietë që përmban sasi të larta karbohidratesh dhe yndyrërash, derisa në shfaqjen e shenjave të sindromës metabolike. Kur janë krahasuar minjtë që gjatë tetë javëve kanë pirë nga një filxhan kafe të përforcuar me esencën e gjethes së ullirit me ata të cilët kanë pirë vetëm kafe, janë vënë re përmirësime në shenjat metabolike kardiovaskulare dhe të mëlçisë. Duke theksuar se esenca e gjethes së ullirit për shkak të veçorisë anti-inflamatore të dobëson, specialistët u shprehën kështu: "Mendohet se çaji jeshil, safrani, aspirina apo të ngjashme me ibuprofenin ndikojnë në dobësim". Në studimin e publikuar në revistën mjekësore "American Journal of Nutrition" bëhet e ditur se rezultatet e marra nga minjtë i kanë kaluar parashikimet e specialistëve.



Mungesa e oksigjenit

shkakton probleme psikologjike

Marrja e një sasive të madhe oksigjeni rrit aktivitetin e funksioneve mendore si motivimi, mësimi përmendsh dhe kuptimi. Glukoza, lënda djegëse e trurit e cila mundëson energjinë që i nevojitet atij, duhet të merret në mënyrën e duhur. Pjesa më e madhe e problemeve psikologjike lindin nga mosmarrja e sasisë së mjaftueshme të oksigjenit nga truri dhe nga mosmarrja e glukozës në nivelin e duhur. Truri ynë përbën 2% të peshës së përgjithshme të trupit, por harxhon afërsisht 20% të kalorive të marra gjatë ditës. Truri është organi që harxhon më shumë energji në trup. Kur mendojmë se të gjitha funksionet e mrekullueshme të trupit tonë drejtohen nga truri duhet ta pranojmë si një të vërtetë të pakundërshtueshme. Mitokondritë, vatrat e energjisë së qelizave të cilat ushqehen me anë të ushqimit të marrë ashtu siç kaceku ndez zjarrin, ashtu dhe ata duke lëvizur e kthejnë ushqimin në energji.

Prandaj është shumë i rëndësishëm roli i oksigjenit në të tilla funksione. Studimet e bëra rreth të menduarit produktiv tregojnë se marrja e një sasive më të madhe të oksigjenit në mënyrën e duhur rrit produktivitetin e aktiviteteve mendore si motivimi, mësimi përmendsh, mësimi, konceptimi. Edhe marrja

e glukozës e cila mundëson energjinë e trurit në mënyrën e duhur (as pak e as shumë) rrit produktivitetin, sepse truri nuk e depoziton glukozën, por e merr vazhdimisht nëpërmjet qarkullimit të gjakut.

Pjesa më e madhe e problemeve psikologjike lindin për shkak të mosmarrjes së mjaftueshme të sasisë së oksigjenit dhe të glukozës.

Prandaj, frymëmarrja e rregullt dhe ushqyerja e ekuilibruar është shumë e rëndësishme. Bëhet e ditur se dëmtimi i disa zonave të trurit, plagosja dhe mosmarrja e oksigjenit të mjaftueshëm gjatë lindjes shkakton çrregullime në kuptimin e gjërave, si dhe në sjellje. Kur oksigjeni nuk arrin në



tru, siç ndodh në çrregullimet organike, si p.sh ndikimi i stresit në kiminë e trupit (çrregullimet depresive pas një traume), mungesa e përqendrimit dhe çrregullimet e hiperaktivitetit, çrregullimet e ushqyerjes, diabeti, mungesa e hekurit, problemet e tiroideve, sëmundjet e enëve të gjakut etj., shkaktjnë çrregullime në të menduar. P.sh., problemi psikologjik “çrregullimi obsesiv, kompulsiv”, i cili shfaqet nëpërmjet fiksimit mbi disa gjëra është një çrregullim mendimi për këtë arsye.

Në qytetet e mëdha mungesa e oksigjenit është më e madhe

Gjatë një krize paniku, problemeve në të folur, problemeve të përqendrimit dhe motivimit shihet se nuk arrihet një frymëmarrje e rregullt nën ndikimin e stresit. Industrializimi, jeta e qytetit dhe ndotja e ajrit janë të ndërthurura me stresin. Studimet e realizuara tregojnë se në vendet e industrializuara, si Amerika dhe në qytetet e mëdha, mushkëritë e njerëzve nuk arrijnë të mbushen në kapacitetin e kërkuar dhe nuk kryejnë frymëmarrje të rregullta. Në vende të tilla, krizat e panikut shihen më shumë se në vende më natyrore. Stresi arrin të ngushtojë enët e gjakut dhe në këtë mënyrë pengon kalimin e oksigjenit deri tek qelizat. Si rrjedhojë, shfaqen çrregullime në të menduar dhe në trup fillojmë të ndiejmë mpirje, pickime apo dhimbje. Duhet të dimë rrugët të cilat na ndihmojnë të luftojmë stresin. Shkurtime mund t'i përmbledhim:

marrëdhënieve me miqtë dhe familjen,
në aktivitete të cilat ndikojnë pozitivisht në
e personalitetit, zgjidhja e problemeve
gjakftohësi, mendimi optimist, pushimi,
i muskujve, aktivitetet sportive, shëtitja
në ajër të pastër dhe frymëmarrja
e rregullt. Mënyra e frymëmarrjes së
rregullt është më e përshtatshme
të mësohet nga një specialist.
Megjithatë, përveç aktiviteteve të
lartpërmendura, nëse ju nuk dini të
kryeni një frymëmarrje të rregullt, mund
të përmirësoni mënyrën e frymëmarrjes.



Shembull për një frymëmarrje të thellë

1. Mënyra e një frymëmarrjeje të shëndetshme është marrja e ajrit nga hunda, pa zhurmë dhe ngadalë. Para se të filloni ushtrimin mbyllni sytë duke vendosur dorën e djathtë mbi bark dhe të majtën mbi krahvor.
2. Në fillim, çliroini mushkëritë mirë duke nxjerrë frymën jashtë (mos i sforconi mushkëritë).
3. Me imagjinatën tuaj ndajeni në tre pjesë kapacitetin e mushkërive. Dhe duke numëruar një-dy, ashtu sikur fryni një tollumbace, imagjinoni sikur mushkëritë tuaja janë mbushur me ajër. (ky proces mund të marrë afërsisht 5 sekonda). Në fillim imagjinoni se është mbushur pjesa e poshtme, pastaj ajo e mesmja dhe në fund pjesa e sipërme. Duke numëruar një-dy, çlironi frymën e marrë në dyfishin e kohës së mëparshme. Prisni dy sekonda. Merrni dhe jepni një frymë të thellë. Derisa ta përsërisni ushtrimin merrni tre ose katër herë frymë normalisht. Nëse vazhdoni të merrni frymë thellë pa marrë frymë normalisht, mund t'ju shkaktojë marrje mendsh.

Mos kini frikë nga gërhitja!



Të gërhiturit është një problem i rastisur shpesh. Të gjithë ju njihni të paktën një njeri nga familja apo nga rrethi familjar që gërhet. Çfarë është gërhitja dhe si mund të kurohet? Disa mund të bëjnë shaka me ju, të tallen për shkak të gërhitjes, por kjo mund të jetë një shenjë e një sëmundjeje serioze e njohur si OSA, gjumë obstruktiv apnes. Kjo sëmundje është parë dhe analizuar nga specialistët e gjumit dhe nga kjo duhet të mësohet sesi të ndalet gërhitja. Për ato të cilët nuk gërhasin për shkak të kësaj sëmundjeje, problemi nuk paraqitet aq serioz dhe për të ndaluar gërhitjen mund të merrni disa masa paraprake.

Çfarë është gërhitja? Gërhitja është zëri që del gjatë frymëmarrjes së personit kur ai është në gjumë. Ky zë dridh qiellzën e lartë dhe gjuhën e vogël. Kuptimi i fjalës Apnes është ndalimi i frymëmarrjes. Fatkeqësisht, gërhitja shihet më shumë te burrat, sesa te gratë.

Kurimi i gërhitjes: Pika më e rëndësishme në kurimin e OSA është zgjidhja e disa problemeve të lidhura me kurimin. Nëse doni të kuroni gërhitjen, shikoni me kujdes këshillat e mëposhtme:

Faktorët jetikë: Gjatë kurimit të OSA duhet të hiqen disa faktorë. Heqja e tyre mund ta zgjidhë problemin. Kilet e tepërta sjellin një mënyrë pasive të jetuari dhe hap rrugën e problemeve të tiroideve. Por, nëse jeni në peshë ideale, atëherë ky proces është krejt i kundërt.

Konsumimi i cigares: Të gjithë i njohim efektet negative të cigares në trupin tonë. Cigarja ndikon shumë edhe në gërhitje. Tym i duhanit shkakton fryrjen e cipës së hundës dhe indeve të fytyrës dhe bllokimin e enëve të vogla të mushkërive.

Rregulli i gjumit: Gjumi i shëndetshëm ndahet në dy etapa. Në etapën e parë është pjesa kur na vjen gjumi, kjo etapë mund të përsëritet disa herë gjatë natës. Ndërsa gjumi REM është gjumi ku shihen shpesh ëndrrat. Nëse një person nuk bën gjumë të rregullt gjatë kohës së gjumit, mund të shfaqen probleme serioze në frymëmarrje. Prandaj, në këtë rast, duhet të rregulloni gjumin dhe të fleni të paktën 7,5 orë.

Problemet mjekësore: Nëse te personi ka ndonjë element që shkakton bllokimin e hundës, gojës apo të mushkërive, atëherë mund të ndikojë në zhvillimin e Apnesit të gjumit. Brenda problemeve të hundës hyjnë të gjitha llojet e alergjive dhe tharja, e cila shkaktohet në fyt nga soba me dru. Mes faktorëve që bllokojnë fytyrën janë bajamet e mëdha, niveli i lartë i indeve yndyrorë dhe rritja e disa indeve të përziera pas fytyrës. Në këtë rast, operacioni mund të ndihmojë në heqjen e pjesëve të padëshiruara dhe të tepërta.

Stili i jetesës para operacionit: Nëse gërhisni shumë dhe familja e të afërmit tuaj ankohen, duhet të analizoni me shumë kujdes listën e stilit të jetesës. Lërimi disa zakone të këqija dhe bëni më shumë ushtrime. Nëse vazhdoni të gërhisni edhe pasi keni bërë ndryshimet, atëherë duhet të shkoni tek specialisti i rrugëve respiratore.

*Përgatiti: Aisa Kaduku Kokiçi
Marrë nga Gazeta Start*



Kompjuteri rrit shqetësimet në Sy

Qëndrimi i gjatë përpara kompjuterit ka dyfishuar shqetësimet te sytë dhe shumë persona përballen me tharje dhe djegie të tyre. Studiuesi i sëmundjeve të syrit, prof. dr. Timuçin Yilderim, veç këshillës për të qëndruar sa më larg të jetë e mundur nga kompjuteri, këshillon që të zgjidhet një kompjuter me ekran të madh dhe shkronja të mëdha, sesa të afrohet syri pranë ekranit. Dr. Yilderim thekson se shqetësimet astigmatike dhe hipermetropike tek personat që qëndrojnë shumë para kompjuterit, shoqërohen me dhimbje dhe kruajtje të syve. Sipas studiuesit turk, nëse shqetësimet tek përdoruesit e kompjuterit janë të mëdha, atëherë ekziston rreziku për një thyerje të fshehtë brenda syrit.

Distanca prej 30-40 cm shkakton lodhje të syrit

Prof. dr. Timuçin Yildirim këshillon që syri të lodhet sa më pak të jetë e mundur. Ai thekson se distanca prej 30-40 cm është mëse normale për leximin e librave, qëndrimin para kompjuterit dhe punimeve që kërkojnë përqendrim. "Kompjuteri është më shqetësuesi, duke pasur parasysh se aty shfaqen objekte që lëvizin, dridhen dhe që përmbajnë ngjyra të forta", - deklaron studiuesi. "Duke punuar për orë të tëra para kompjuterit, sytë fillojnë të skuqen dhe të djegin, duke u pasuar më pas edhe nga probleme të përhershme", - deklaron prof. dr. Yilderim. Ai vë në dukje edhe rrezikun e shfaqjes së miopisë tek moshat e reja që qëndrojnë për orë të tëra përpara kompjuterit.

Përdorni ekrane të mëdhenj dhe mos fikni dritën e dhomës

Studiuesi këshillon që të qëndrohet sa më larg të jetë e mundur nga ekranin e kompjuterit, duke shtuar: "Në vend që t'i afroheni ekranit kur keni vështirësi në të parë, më mirë është që të zgjidhet një ekran më i madh.

Gjithashtu, duhet të zgjidhet një kontrast sa më i ulët dhe më i butë". Sipas prof. dr. Yilderim, ndriçimi i dhomës duhet të jetë i plotë dhe në rast se si pasojë e punës së gjatë para kompjuterit keni tharje të syrit, atëherë këshillohet edhe lagje artificiale. "Pasi të keni punuar për një orë mbi kompjuter, atëherë duhet të pushoni për dhjetë minuta duke i mbyllur sytë, ose duke e hedhur shikimin në pamje të largëta që janë qetësuese. Pasi qëndroni për disa orë ulur në një pozicion të palëvizshëm, atëherë ngadalësohet edhe qarkullimi i gjakut që bëhet shkak për mpiksjen e tij. Nëse të gjitha këto bëhen shqetësim për sytë, atëherë këshillohet një vizitë me mjekun okulist", - deklaron prof. dr. Yilderim.

Njësinë qendrore të kompjuterit vendoseni poshtë tavolinës

Duke u bazuar në studimet elektromagnetike, studiuesi turk vë në dukje se kjo pjesë e kompjuterit ndikon negativisht edhe në sy. Ai thotë se njësia qendrore e kompjuterit duhet të vendoset domosdoshmërisht poshtë tavolinës.

Pijet e gazuara dëmtojnë kockat

Është vërtetuar se sasia e lartë e fosforit që përmbajnë pijet e gazuara duke rritur fosforin në gjak rrisin dhe nivelin e hormonit që merr kalcium nga kockat dhe pas një kohe të caktuar për shkak të pakësimit të kalciumit, kockat humbasin fortësinë e tyre.

Shefi i degës së endrikologjisë, diabetit dhe sëmundjeve të fëmijëve në fakultetin e Mjekësisë së Universitetit Kocaeli, prof. dr. Shukru Hatun, deklaroi se obeziteti sa vjen e shtohet dita ditës dhe në vitet e fundit po rrezikon seriozisht shëndetin e fëmijëve. Duke nënvizuar faktin se obeziteti nuk duhet të shihet vetëm si një sëmundje e shkaktuar nga shëndoshja e tepërt, dr. Hatun pohoi se me kalimin e kohës obeziteti bëhet shkak për shfaqjen e sëmundjeve të sheqerit, problemeve serioze si sëmundjet e zemrës dhe sëmundjet kronike. Duke theksuar se konsumimi i tepërt i pijeve të gazuara që përmbajnë shumë sheqer hap rrugën e ndikimeve negative mbi shëndetin e njeriut, dr. Hatun tha se konsumi i pijeve të gazuara rritet dita ditës.

“Për shkak të përmbajtjes së lartë të sheqerit, pijet e gazuara nga njëra

anë rrisin sheqerin në gjak dhe kështu duke rritur hormonin e insulinës bëjnë të mundur që trupi të depozitojë sheqerin. Nga ana tjetër, moskonsumimi i qumështit dhe i nënprodukteve të shëndetshme të tij që janë baza e të ushqyerit përbën një rrezik për peshën e trupit”, - u shpreh ai. Përveç kësaj, në rastet kur pijet e gazuara shoqërohen edhe me ndonjë ushqim fast-food apo nëse konsumohet më shumë se duhet ushqim, dr. Hatun tha se “Autoritetet e shëndetit për fëmijët në SHBA i këshillojnë fëmijët të qëndrojnë larg pijeve të gazuara. Pijet e gazuara dëmtojnë kryesisht kockat. Revista mbi shëndetin e fëmijëve, “Shoqata e Mjekëve Amerikanë” publikoi një studim në të cilin tregohet se tek vajzat e shkollës së mesme të cilat konsumojnë rregullisht pije të gazuara rastet e thyerjeve në kocka janë rritur tre herë



Intervistë me Brunilda Qazimin

Nxënëse në medresen e Tiranës, klasa X. (Fituese e çmimit të parë në konkursin e Kur'anit zhvilluar mes Medreseve të vajzave të qytetit të Tiranës dhe të Korçës)



1. Kur keni filluar të lexoni Kur'anin?

Për herë të parë, unë kam filluar të mësoj Kur'anin në vitin 2006.

2. Çfarë ju ka tërhequr më shumë në mësimin e Kur'anit?

Që e vogël jam tërhequr pas mësimin të Kur'anit dhe gradualisht më është shtuar dashuria për Kur'anin.

3. Sa afër e ndieni praninë e tij?

Duke e lexuar vazhdimisht me zemër e ndien vetvetiu mrekullinë e tij.

4. A keni pasur vështirësi gjatë mësimin të Kur'anit?

Ka qenë kënaqësi të mësoja Kur'anin duke qenë se që në fillim e kisha me pasion.

5. Kush ju ka nxitur ta mësoni atë?

Për të mësuar Kur'anin më ka nxitur trashëgimia familjare.

6. Me kë e keni filluar mësimin e Kur'anit dhe aktualisht nëse vazhdoni të mësoni, cili është mësuesi juaj?

Mësimin e Kur'anit e kam filluar me znj. Vjollca Feza, ndërsa aktualisht e vazhdoj me mësuesen time të Kur'anit në Medrese.

7. Çfarë metode përdorni ju për mësimin e tij?

Mësoj ajetet një nga një dhe i memorizoj ato dhe në fund, bëj lidhjen e tyre.

8. A jeni e kënaqur me arritjet tuaja në mësimin e Kur'anit?

Falënderoj Allahun që kam arritur deri këtu dhe shpresoj të arrij më shumë duke qenë se jam në fillimet e mia.

9. Së fundi, cili është mesazhi juaj për bashkëmoshatarët e tu në lidhje me mësimin e Kur'anit?

Mesazhi im për të gjithë bashkëmoshatarët e mi është që të vazhdojnë mësimin e Kur'anit sepse me të vërtetë ai është çelësi i suksesit dhe dhënësi i përgjigjeve të pikëpyetjeve të shumta që shqetësojnë këtë moshë.


Faleminderit znj. Brunilda dhe ju urojmë suksese të mëtejshme.

Faleminderit juve.

Intervistoi: Liseda Ramaj

Të njihemi me librat e rinj


exues të dashur të revistës Këshilla, ndër botimet tona të reja janë revista **“Drita e Kur’anit”**, nr. 1, 2011 ku janë pasqyruar artikuj shkencorë mjaft të vlefshëm për të gjithë ata që duan të mësojnë më shumë mbi mrekullinë e Kur’anit; gjithashtu, sapo kanë dalë nga shtypi dy libra të botuar nga shoqata “Filadi”: **“Mesazhi i të drejtave”**, me autor Imam Ali Ibn Husejn dhe **“Imam Xhafer Sadiku”**, me autor Muhamed Husejn Mudhafar.



“Drita e Kur’anit”, nr. 1, 2011



“Mesazhi i të drejtave”,
me autor
Imam Ali Ibn Husejn



Imam Xhafer Sadiku”

Salam!



Gëzuar Muajin E Madhëruar të Ramazanit!



Më i mirë nga çdo muaj tjetër

Ditët me ty janë të këndshme. Sa shumë e pëlqej aromën e ardhjes tënde! Kur jam me ty ndihem më shumë pranë Zotit. Kur e ndiej aromën tënde, dua që të vish sa më shpejt. Dua që të jem në pritje e të ulem në sofrën e iftareve të tu. Dua që në mes të natës të zgjohem për syfyr me dëshirën më të madhe. Sa i embël bëhet zëri i ezanit kur ti të kesh ardhur. Kur dëgjoj zërin e (Rabbena) “O Zoti ynë!” ndiej aromën e Xhenetit. Çdo ditë kur afron koha e iftarit, e ndiej veten në Xhenet dhe u krenohem të gjitha krijesave (botëve, universit).


Kur ti vjen, mua më bën prej mysafirëve të Zotit.

Çfarë kënaqësie është të jesh mysafir i Zotit.

Gëzuar muajin e bekuar të Ramazanit!



Mina Mekami



Ramazani , festohet kudo në botë!

Rrobat e reja

Në të gjithë
shtëpinë
ndihej
aroma e

ushqimit.

Në kuzhinë, mamë
ishite djersitur e
tëra.

Babai u kthye në
shtëpi i lodhur dhe
merrte frymë me
shpejtësi.

Babi im punon nga
mëngjesi deri në
mbrëmje. Ashtu
edhe mamë.

Mirëpo, mua nuk më
harron, sepse më ka
blerë rroba të reja.
O Zot i Dashur!

Kush u gatuan
ushqim të shijshëm
fëmijëve të cilët nuk
kanë mamë?

Kush u blen rroba të reja fëmijëve të cilët nuk kanë babë?

O Zot i Mëshirshëm!

Sigurohu rroba të reja fëmijëve jetimë dhe ushqime të shijshme
për ta!



Edukimi fizik – 10

Babi kishte ardhur në shkollë të shihte gjendjen e mësimeve të mia. Zemra më rrihte fort. E dija që mësuesi nuk ishte i kënaqur nga mësimet e mia. Mësuesi doli jashtë nga zyra. Lista e notave ishte në dorën e tij. Unë ula kokën poshtë. Mësuesi tha: Shikoni! Këto janë notat e djalit tuaj. Të gjitha notat e tij janë 6 dhe 7. Unë nuk jam i kënaqur nga mësimet e djalit tuaj. Djali juaj në vitet e para ka qenë nxënësi i parë, mirëpo këtë vit ka rënë nga mësimet. Unë, me lejen tuaj, kam vendosur ta ndëshkoj. Babi tha: Më falni zoti mësues! Të gjitha notat e djalit tim janë të ulëta?



Mësuesi i dëshpëruar tundi kokën dhe tha: Po, të gjitha notat afërsisht kështu janë. Vetëm nota e edukimit fizik është përmirësuar. Është 10.

Babi për një moment buzëqeshi dhe tha: Domethënë edukimi fizik është mirë?

Mësuesi tha: Po, edukimin fizik e ka më mirë nga fëmijët e tjerë.

Babi tha: Nuk ka problem zoti mësues. Ju, për arsye të notave të ulëta, dënojeni. Unë, për arsye të notës së mirë në edukimin fizik, do t'i blej një top dhuratë.

Mësuesi me habi tha: Ju doni t'i bleni fëmijës tuaj dhuratë?

Babai pyeti: Pse çfarë problemi ka? Ai që dënohet për notat e këqija duhet të inkurajohet për notat e mira. Ai, patjetër, duhet të jetë lodhur për të marrë notën 10 në edukimin fizik.

Kur po ktheheshim me babin për në shtëpi, unë i turpëruar, i thashë babit: Babi do të më falësh?

Babi më vuri dorën mbi kokë dhe më tha: Bir! Dua që të bëhesh një sportist shumë i mirë dhe i madh.



E SHKURTËR DHE E LEXUESHME

- Të gjitha mjellmat e Anglisë janë pronë e mbretërisë angleze.
- Qukapikët mund të qukasën 200 herë në sekond në trungun e pemës.
- Dhëmbi i elefantit peshon 4 kg.
- Mizat hanë ushqim me këmbët e tyre.
- Bretkosat e marrin ujin e nevojshëm nëpërmjet lëkurës, kështu që nuk kanë nevojë për të pirë ujë.
- Gjuha e balenës blu peshon sa një elefant.
- Syri i strucit është pak më i madh nga truri i tij.
- 95 % e yjeve blu janë të përbëra nga uji.
- Peshkaqenët sëmuren ngadalë.
- I vogli i kalit të ujit lind në ujë.
- Asnjë pinguin nuk jeton në polin e veriut.
- Në helmin e gjarpërit, ndodhet plumb vdekjeprurës.
- Elefantët mund të pinë 60 gallon (1 gallon = 4.54 litër) ujë dhe të hanë 250 kg jonxhë.
- Disa nga peshkaqenët bëjnë vezë.

Hasan Abedi



Histori turkmenistani

(fis që jetojnë në veri të Iranit)



*N*a ishte
një qytet
i gjelbër.

Mbreti i qytetit ishte një burrë i shëndoshë dhe dembel. Të gjitha punët e qytetit ia kishte dorëzuar ministrit. Kështjella e mbretit ndodhej në një majë mali. Ishte e rrethuar e gjitha. Askush nuk mund të hynte në kështjellë pa lejen e rojeve. Mbreti kishte dhënë urdhër që kështjellatë ndërtohej prej guri. Ai mendonte

se ishte më i zgjuari dhe më i forti, kështu që duhej të kujdesej për jetën e tij.

Një ditë mbreti bëri një festë të madhe dhe kërkoi nga të gjithë njerëzit që t'i bënin çfarëdolloj pyetjeje dhe të thonin çfarëdolloj gjëegjëze. Njerëzit e qytetit e dinin që mbreti vetëm gjëegjëzave të thjeshta mund t'u përgjigjej. Nga frika e tij bënin vetëm pyetje të thjeshta. Mbreti i gëzuar u përgjigjej pyetjeve të tyre. Festa zgjati tri ditë e tri netë. Në ditën e tretë erdhi lajmëtari i mbretit të tokës fqinje dhe dha lajmin: "Mbreti i qytetit "diell" di një gjëegjëzë dhe nesër do të vijë në qytet."

Mbreti i tha ministrit: "I gjithë qyteti duhet të shkojë për pritjen e tij.



Mbreti i qytetit "diell" duhet ta kuptojë se sa forcë kemi."

Të nesërmen në mëngjes, sapo zbardhi drita, mbreti i qytetit "diell" me disa njerëz hynë në qytet. Mbreti e futi në kështjellën e tij. Mbreti i qytetit "diell" kishte bërë një plan që t'i merrte mbretit kështjellën dhe qytetin e bukur. Mbreti ia tregoi të gjitha vendet e kështjellës mbretit mik. Mbreti i qytetit "diell" pyeti: "Çdolloj pyetjeje mund t'i përgjigjesh?"

Mbreti buzëqeshi i gëzuar dhe u përgjigj: "Gjëegjëzave (mistereve) më të vështira mund t'i përgjigjem." Mbreti i qytetit "diell" pa njërin nga shoqëruesit dhe i tha diçka në vesh. Pas disa sekondash hyri me një thes dhe nxori disa copa lëkure dhe i vuri para mbretit.

Mbreti i qytetit "diell" të cilit i bënin sytë xixa nga gëzimi tha: "Si mund ta vendosësh qytetin dhe kështjellën në mes këtyre lëkurave?"

Mbreti u mendua e u mendua, por nuk mundi të gjente përgjigje të saktë. U këshillua edhe me ministrin, por as ai nuk mundi të jepte përgjigje të saktë.

Mbreti i qytetit "diell" tha: "Keni tri ditë kohë që të jepni përgjigjen e gjëegjëzës, përndryshe kjo kështjellë dhe ky qytet i bukur do të bëhet i imi. Nëse ke dëshirë mund të luftojmë e të shohësh se kush është më i fortë." Më pas, u largua nga kështjella.

Mbreti i kështjellës dha urdhër që të mblidheshin të gjithë këshilltarët, komandantët dhe të mëdhenjtë e kështjellës.

As ata nuk mundën të gjenin përgjigje të saktë. Një nga të moshuarit, që shkruante letrat e mbretit, tha: "T'i themi popullit. Ndoshta mund ta gjejë ndonjëri përgjigjen e saktë." Mbreti me shqetësim tha: "Kur nuk munda unë, do të mundet populli...!" Të gjithë e pranuan fjalën e të moshuarit; vetëm mbreti jo.

Kaluan dy ditë. Mbreti mendohej e mendohej por asgjë. Në mëngjesin e ditës së tretë mbërriti lajmëtari i tokës diellore dhe tha: "Mbreti do të vijë pas përëndimit të diellit për të marrë përgjigjen e pyetjes."

Mbreti, si e paveten ngushtë, vendosi që ta dëgjonte fjalën e të mëdhenjve dhe vendosi që të merrte ndihmën e popullit. Dha urdhër që të pyesnin çdo njeri dhe atij që do të jepte përgjigjen e saktë do t'i jepte një kuti





me florinj. Në kështjellë u mbledhën një numër i madh njerëzish, por askush nuk mundi të jepte përgjigje të saktë. Dielli, pak nga pak, filloi të fshihej pas pemëve dhe perëndimi po afronte. Ministri pyeti rojen nëse kishte mbetur njeri tjetër pa dhënë përgjigje. Një nga rojet tregoi me gisht dhe tha: "Ka ardhur vajza e çobanit dhe thotë se mund t'i përgjigjet gjëegjëzës." Mbreti dha urdhër që ta thërrisnin brenda në kështjellë vajzën. Vajza e vogël la delet e saj në oborrin e kështjellës dhe tha: "Më sillni lëkurat."

Mbreti që ishte i shqetësuar dha urdhër që të sillnin lëkurat. Më pas, nxori nga trasta e saj një palë gërshërë dhe filloi të priste lëkurën në fije të holla si pe. Më pas, i mbledhi në formë lëmshi dhe tha: "Me këto lëmshe rrethoni qytetin rreth e qark." Mbreti me shpejtësi e rrethoi qytetin me fijet e lëkurës. Mbreti i qytetit "diell" kur e pa që i kishin dhënë përgjigje gjëegjëzës së tij, i mërzhitur u kthye në tokën e tij.

Mbreti i dha një kuti të mbushur plot me florinj vajzës së çobanit dhe sa herë që kishte ndonjë problem, ministri këshillohej me vajzën e vogël.





KUSH I KREU DETYRAT E PATRIKUT?

Patriku asnjëherë nuk i kryente detyrat. Ai thoshte: "Kjo është punë e lodhshme." Në vend që të kryente detyrat, luante basketboll, futboll etj. Mësuesit i thonin: "Patrik! Nëse nuk kryen detyrat nuk mëson gjë." Kjo që thonin ishte e drejtë. Por, ç'të bënte, ai i kishte inat detyrat. Çfarë duhet të bënte?

Një ditë, macja po luante me një kukull. Patriku e mori kukullën nga macja dhe me habi pa që kukulla nuk ishte lodër, por një burrë i vogël me rroba të leshta dhe me një kapele të kuqe e të gjatë si kapelet e magjistarëve. Kukulla thërriste: "Më shpëto! Mos më lër në dorën e kësaj maceje. Unë do të të plotësoj dëshirat e tua. Të premtoj! Patrikut nuk i besohej se sa me fat që ishte. Ai e mori përgjigjen e të gjitha problemeve të tij.



Patriku tha: "Ti vetëm më kryej detyrat për 35 ditë, deri në përfundim të shkollës. Nëse ti i kryen ato mirë, unë të premtoj që nuk do të të hedh tek macja." Fytyra e burrit të vogël u rrudh si një picetë.

Ai nguli këmbët në tokë dhe mblodhi grushtat. Shtrëmbëroi buzët dhe i nevikosur tha: "Më është shpifur, por do ta bëj këtë punë." Burri i vogël filloi të kryente detyrat e Patrikut. Mirëpo, problemi ishte se ai nuk e dinte se çfarë duhej të bënte. Ai kishte nevojë për ndihmë. Ai thoshte: "Më ndihmoni! Më ndihmoni!" Kështu që Patriku u detyrua që në çdo mënyrë ta ndihmonte. Kur burri i vogël shkruante detyrat e tij, ulërinte e thoshte: "Unë nuk e di kuptimin e kësaj fjale! Më jepni një fjalor! Jo, më mirë është të gjesh fjalën dhe ta lexosh për mua." Kur i erdhi radha e matematikës, Patriku nuk kishte asnjë mundësi që të shpëtonte prej tij. Kukulla e vogël e tërhiqte Patrikun nga pas e i thoshte: "Programi i kësaj lënde çfarë është? Çfarë do të thotë të mbledhësh e të shumëzosh; unë nuk njoh asnjërin prej tyre...! Ulu pranë meje dhe më udhëzo se çfarë duhet të bëj!"

Xhuxhat nuk dinë asgjë nga historia. Historia për ta është një sekret. Kështu, përsëri dëgjoheshin ulërimat e xhuxhit të vogël: "Shko në bibliotekë dhe më sill libra, shumë libra, më shumë, më shumë!!! Më ndihmo që t'i lexoj ato!"

Burri i vogël çdo ditë ankohej e ankohej. Patriku nga ana tjetër, përpiquej e punonte shumë. Ai rrinte natën zgjuar dhe me sytë e fryrë e të lodhur shkonte në shkollë. Deri më tani kurrë nuk ishte lodhur aq shumë. Më në fund, erdhi dita e fundit e shkollës dhe xhuxhi i vogël u lirua. Tani nuk kishte më detyra për të. Xhuxhi ia mbathi nga dera e pasme e shtëpisë. Patriku e kaloi klasën me sukses. Shokët ishin të habitur. Mësuesit qeshnin nga gëzimi dhe ishin shumë të kënaqur nga ai. Babai dhe mamaja e Patrikut, gjithashtu, ishin të shokuar nuk e dinin se çfarë kishte ndodhur me djalë të tyre. Ai ishte kthyer në një djalë të rregullt, dhoma e tij ishte e sistemuar. Punët e tij i kryente menjëherë. Tashmë ishte edhe i kulturuar. Kishte ndryshuar nga Patriku i parë.

Patriku mendonte se të gjitha detyrat ia kishte kryer burri i vogël. Por, në të vërtetë, të gjitha detyrat i kishte kryer vetë.



Mosha e njerëzve në kohë të ndryshme

Këtë radhë dua t'ju tregoj diçka, që po ta dëgjoni, nuk do t'ju duket edhe aq e këndshme.

Thonë se në të shkuarën, njerëzit jetonin shumë gjatë, si profeti Nuh (paqja qoftë mbi të!), i cili sipas thënieve kur'anore ka jetuar 950 vjet duke ftuar njerëzit në adhurimin e një Zoti. Pas shumë vitesh i është shpallur profetësia dhe pas saj ka jetuar 950 vjet!

Thonë se një herë, kur profeti Isa (paqja qoftë mbi të!) po kalonte nga varrezat, pa një plakë të moshuar e të thinjosur, e cila ishte ulur pranë një varri e thoshte: "Shpirt i dashur..."

Profeti Isa (paqja qoftë mbi të!) i shkoi pranë dhe i tha: "Nënë, kush është ky?"
-"Djali im, i cili ia dha shpirtin vdekjes."

Ai e pyeti: "Sa vjeç ka qenë?"

-"Shpiti im, fëmija im vetëm 200 vjet jetoi. "

Profeti Isa (paqja qoftë mbi të!) i tha: "A do të të tregoj se sa do të jetojnë njerëzit e kohëve që do të vijnë? Ata nuk do të jetojnë më shumë se 70-80 vjet."


Gruaja e moshuar më habi i tha: "Në këtë kohë kaq të shkurtër çfarë do të bëjnë?"

Profeti Isa (paqja qoftë mbi të!) i tha: "Uuuuu, ndërtojnë shtëpi, grinden për pasurinë e kësaj bote..."

Gruaja e moshuar: "Po të isha në vendin e tyre, unë këto 70 vjet do t'i kaloja vetëm në sexhde; kjo nuk është një jetë e gjatë që njeriu ta kalojë me gjëra të kota."



Të njihemi me Kur'anin Sure "Xhin"



Surja Xhin është surja e 72-të e Kur'anit. Kjo sure ka 28 ajete dhe 276 fjalë. Është surja e 40-të e Kur'anit e cila i është zbritur profetit Muhamed (Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) në qytetin e Mekes. Emri i kësaj sureje është marrë nga ajeti i parë i saj në të cilin përmendet fjala xhind. Kjo sure flet për qeniet e padukshme që quhen xhind.

Përmbajtja e sures

Këtë sure mund ta ndajmë në tri pjesë:

- 1- 19 ajetet e para rreth xhindeve
- 2- Disa ajete më poshtë rreth Njësimit të Zotit dhe Ditës së Gjykimit
- 3- Ajeti i fundit flet për dijen e Zotit rreth dijes së fshehtë.
- 4- Çfarë janë xhindet?

Njerëzit flasin fjalë të ndryshme rreth xhindeve, por shumica e tyre gabojnë. Fjala **xhind** në gjuhën arabe do të thotë (e padukshme). Për arsye se këto qenie janë të padukshme quhen xhinde. Ata jetojnë mbi tokë, mirëpo njerëzit nuk i shohin. Zoti na tregon në Kur'an për ta se në të vërtetë, këto qenie jetojnë. Dhe, Ai na tregon edhe dhjetë cilësi të tyre si: Ata janë të krijuar nga zjarri, një grup i



tyre janë besimtarë dhe një grup janë mohues, të parët mund të shkonin në qiell, mirëpo me ardhjen e Islamit nuk mund të shkojnë më, mund të kenë lidhje me njerëzit etj.

Si zbriti surja Xhin?



48

Dijetarët për zbritjen e kësaj sureje na tregojnë tri tregime:

1- Në kohën e Profetit të Islamit (Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), çdo vit në qytetin e Taifit, i



cili ndodhej pranë Mekes, ngrihej një treg ku mblidheshin njerëzit. Një herë, Profeti (Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) shkoi në tregun e Taifit për t'i ftuar njerëzit në fenë islame. Në kthim qëndroi diku pranë qytetit për t'u çlodhur. Ndërkohë që po çlodhej, filloi të lexonte pjesë nga Kur'ani. Një grup xhindesh dëgjuan leximin e Kur'anit dhe erdhën pranë Profetit dhe u bënë myslimanë. Në këto momente, Zoti zbriti suren "Xhin".

2- Kishte disa muaj që xhindet nuk mund të ngriheshin në qiell e të dëgjonin zërin e melekëve. Sa herë që donin të ngriheshin në qiell, melekët i godisnin. Ata të cilët ishin habitur nga kjo filluan të kërkonin në të gjithë tokën e të mësonin se çfarë kishte ndodhur. Ndërkaq, mbërritën në Meke dhe dëgjuan Profetin (Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) tek sa lexonte Kur'an. Ata e kuptuan se me ardhjen e Profetit gjendja e botës kishte ndryshuar. Ata shkuan pranë tij dhe u bënë myslimanë.

3- Kur u largua nga jeta mbështetësi i Profetit (xhaxhai i tij, Ebu Talibi), jeta e Profetit u bë shumë e vështirë. Mohuesit e mërzisnin më shumë. Profeti (Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) shkoi në Taif që të ftonte në Islam e ndoshta do të gjente shokë të rinj. Mirëpo, edhe atje njerëzit e goditën me gurë. Profeti, i cili ishte i lënduar e me plagë, u kthye. Në rrugë qëndroi të pushonte dhe filloi të këndonte Kur'an. Ndërkaq grupi i xhindeve e dëgjoi zërin e Profetit dhe u bënë myslimanë. E kështu, Zoti zbriti këtë sure.





Qortimi

- Babi! Kur shoku im bën ndonjë gabim, si ta qortoj atë?
 - Duke i thënë se nuk është mirë kjo që po bën.
 - Po sikur të mos mund t'ia them drejtpërdrejt?
 - Mund t'i shkruash një copë letër dhe vendosja në xhep.
- Të nesërmen, kur babai po bëhej gati për të shkuar në punë mori xhaketën dhe pa që në xhepin e tij ishte një copë letër. E mori dhe e hapi: -Ë dashur babi! Të lutem, mos pi më cigare, sepse kjo që po bën nuk është e mirë!



PROVIMI

Katër nxënës, një natë para provimit dolën për të bërë qejf. Atë natë qëndruan jashtë deri vonë. Të nesërmen ishte provimi. Të katërt u ulën të mendonin se çfarë të bënin që provimi të anullohej. Pasi u menduan, shkuan dhe u bënë me vaj makine, rrobat e tyre i bënë pis dhe u nisën për në universitet. U drejtuan drejt mësuesit të tyre dhe filluan t'i shpjegonin ngjarjen duke i thënë: - Mbrëmë ishim në një dasëm dhe tek sa ktheheshim na u shpua goma e makinës. Nuk kishim mundësi që të mbërrinim në kohë. Deri këtu kemi ardhur në këmbë duke shtyrë makinën!

Bënë të pamundurën që mësuesi i tyre të bënte diçka për to. Mësuesi më në fund u tha: - Do t'ju jap tri ditë kohë që të jepni provimin tuaj.



Djemtë të gëzuar nga lajmi u nisën për në shtëpi dhe lexuan me shumë kujdes mësimet e tyre. Në ditën e tretë, të sigurt në vetvete u nisën për në universitet për të dhënë provimin.

Kur i pa mësuesi, u tha se për disa arsye duhej të uleshin secili në një klasë më vete. I siguroi djemtë se provimi ishte shumë i thjeshtë.

Djemtë, ngaqë kishin studiuar shumë mirë këto tri ditë, pa kundërshtuar pranuan dhe u nisën për në klasat që i kishin caktuar. Në dorë u dhanë fletën e provimit, ku për habi, ishin vetëm dy pyetje. Pikët që duhej të merrnin ishin 20.

1) Emri dhe mbiemri (2 pikë)


2) Cila gomë e makinës u shpua? (18 pikë)

a) gomë e parë
djathtas

b) gomë mbrapa
djathtas

c) gomë e parë majtas

ç) gomë mbrapa majtas





MYSAFIRI I VOGËL

Koha e syfyrit ishte afër. Rrugicat i kishte mbuluar aroma e vesës. Frynte një fllad i lehtë. Degët e palmave (hurmave) lëviznin me ngadalë. Flladi përkëdhelte edhe lulët dhe dalëngadalë po hynte në dhomën e Fatimes. Fatimja ishte shtrirë në shtrat. Flladi u ul mbi ballin e saj. Pasi hodhi mbulesën e bardhë mbi të, doli nga dhoma me butësi. Flladi mori frymë dhe e ngriti shikimin e tij në qiell. Qindra yje shikonin në shtëpinë e Fatimes dhe ishin në pritje të një lajmi. Fatimja doli në oborrin e shtëpisë. U drejtua për tek pusi. Mori abdes dhe më pas, ngadalë hyri në dhomë. U lut për të gjithë e më pas, edhe për mysafirin e vogël, i cili ishte në rrugë. Sërish u shtri e nga dritarja shikonte në qiell. Kthehej sa në një anë, në tjetrën dhe mendonte për minutat e vështira por të ëmbla të së nesërmes.

Mysafiri i vogël goditi më lehtësi.

Fatimja vendosi dorën mbi të dhe me butësi, i buzëqeshi.



Pak nga pak, u dëgjua zëra nëpër rrugicë. Zërat sa vinin e afroheshin më shumë. Për një moment, u dëgjua zëri i ezanit, i cili mbushi të gjithë vendin. Fatimja i pëlqen shumë këto momente. Ulet në shtrat dhe fillon të përsërisë fjalët e ezanint një nga një. Në cep të dhomës, i shkuan sytë tek Hasani, i cili flinte qetë në dhomën e gjumit. Diçka i erdhi në mendje Fatimes: – Së shpejti, do të kesh një vëlla të vogël. U ngrit që të falte namazin. Tashmë, aromën e parfumit e ndiente më shumë.

Pasi kaloi një orë, yjet ishin fshehur në qiell. Njerëzit ktheheshin nga xhamia për në shtëpi. Koha ishte zbardhur. Papritur, u dëgjua zëri i një ezani tjetër. Me habi njerëzit shikonin njëri-tjetrin.

– Nga vinte ky zë?

Të gjithë tregonin shtëpinë e Fatimes. Tashmë, edhe ezani i dytë kishte përfunduar. Rrugicat ishin të qeta dhe boshë. Mirëpo, të qarët e mysafirit të sapoardhur kishin mbuluar shtëpinë. Fatimja ishte në shtrat. Hasani qëndronte pranë nënës së tij. Dëgjonte se si qante vëllai i tij i vogël, i cili ishte në krahët e nënës dhe me habi i shikonte duart e vogla të vëllait të tij, Hysejnit.





Dy vëllezërit

Dy vëllezër punonin së bashku në një lëndinë. Një prej tyre ishte martuar dhe kishte familje të madhe. Ndërsa tjetri ishte i vetëm. Vëllezërit, në fund të ditës, atë që fitonin e ndanin përgjysmë. Një ditë, vëllai i pa martuar tha me vete: - Nuk është e drejtë që ne çdo gjë ta ndajmë përgjysmë. Unë jam i vetëm dhe nevojat e mia janë të pakta.

Kështu që vëllai i pa martuar, çdo natë, kur të gjithë ishin në gjumë çohesh dhe mbushte një qese me mall (grurë) nga kasollja e tij dhe e zbrazte në kasollen e vëllait të madh.

Po në këto ditë, vëllai i madh i cili ishte i martuar tha me vete: -Nuk është e drejtë që ne të gjitha gjërat t'i ndajmë përgjysmë. Unë jam i martuar e kam pasuri. Unë kam fëmijë. Kur të rriten ata mund të punojnë kur unë nuk do të mundem më. Ata do të kujdesen për mua. Ndërsa ai është i vetëm dhe nuk i dihet e ardhmja.

Kështu që edhe vëllai i madh çdo natë mbushte një qese dhe kur të gjithë ishin në gjumë shkonte dhe e zbrazte në kasollen e vëllait të tij.

Kaluan disa vite. Të dy vëllezërit ishin të shokuar. Si është e mundur që nga kasollja nuk pakësohet asgjë?! Një natë prej netësh, të dy vëllezërit u përplasën me njëri - tjetrin. Ashtu në mes të natës në errësirë të plotë shohin me habi njëri - tjetrin. E kuptuan përse nuk pakësohej asgjë nga kasollja e tyre. Të përlotur e përqafuan njëri - tjetrin.



PROFETI DHE MIELEKIËT

Shpella "Hira"

Në qytetin e Mekes, në Arabi, ndodhet një shpellë me emrin "Hira". Në kortësi të malit, ndodhet një shpellë e vogël, e cila, në një pjesë të saj ndriçohet nga dielli dhe pjesa tjetër është në errësirë. Ata të cilët shkojnë për të vizituar shtëpinë e Zotit dhe për të kryer Hadhin, vizitojnë edhe shpellën "Hira".

Ai është vendi ku Profeti i Islamit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) kalonte ditë e natë për të biseduar me Zotin.

Sekreti i asaj nate

Para shumë vitesh, në një ndër natët e fundit të muajit Raxheb, në një cep të Mekes dhe në një majë mali (Hira), ndodhi një ngjarje e madhe. Ngjarja ndryshoi gjithë të ardhmen e njerëzimit dhe solli një mesazh të madh. Profeti Muhammed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) ishte 40 vjeç. Atë natë ishte në shpellën Hira si çdo natë tjetër duke adhuruar Allahun. Papritur pa një melek të bukur që hyri në shpellë. Ai afrohej e afrohej. Dukej se kishte një lajm të rëndësishëm. Emri i tij ishte Xhibrail (paqja qoftë mbi të!).



Profeti dhe meleku


Xhebraili kajmëjellës
nga Zoti erdhi në
shpellën Hira pranë
Profetit (Paqja dhe
bekimet e Allahut
qofshin mbi të dhe
mbi familjen e tij!)
që t'i sillte një kajm
të rëndësishëm.

Xhebraili mbante me
vete një shkresë dhe
kërkonte prej Profetit
Muhammed (Paqja
dhe bekimet e
Allahut qofshin mbi
të dhe mbi familjen
e tij!) që ta lexonte.

Profeti tha: 'Unë nuk mundem ta lexoj'. Xhebraili kërkonte prej tij edhe dy herë
të tjera që ta lexonte shkresën. Papritur buzët e Profetit filluan të shqiptonin
fjalët të cilat ishin shkruar.

E, çfarë fjalësh ishin!
Lexo me emrin e Zotit!

Nata e Shpalljes është nata në të cilën Xhebraili shkoi në shpellën Hira për të
vizituar Profetin.



Ishte natë, e cila do të merrte
përsipër një detyrë të rëndësishme.
Xhebraili kishte ardhur që t'i jepte
kajmin e Profetësisë, Hazreti
Muhammedit (paqja dhe bekimet e
All'lahut qofshin mbi të dhe mbi
familjen e tij!) nga All'lahu. Ai
(Xhebraili) kërkonte nga profeti
Muhammed që të lexonte fjalët e
para të fesë së re, Islamit, dhe ato
fjalë janë ajetet e para të sures
"Alek" (Lexo me emrin e Zotit që
krijoi botën!).



Fillimi i rrugës

Kur Profeti i nderuar lexoi ajetet e para të Kur'anit, melekui e pa me mirësi e i tha: - O Muhammed! Ti je i dërguari i Zotit dhe unë jam Xhebraili.

Ai, me këtë fjalë, i komunikoi Profetit një detyrë të rëndësishme. Profeti ishte ngarkuar me detyrën e udhëzimit të njerëzve dhe shpëtimin e tyre nga errësira.

Besimtarët dhe pastërtia

Fjalimi i parë i cili nëpërmjet Xhebrailit i erdhi Profetit nga ana e Zotit tregon se njerëzit janë ftuar në fenë më të plotë; fe, e cila kërkon nga njerëzit që të heqin dorë nga rruga e imoralitetit dhe padija, dhe të hedhin hapat e tyre në të lexuar e në të shkruar. Të përpiqen që të jenë njerëzit më të pastër (shpirtërorë e truporë). Profeti ynë ishte ngarkuar që t'u përcillte këtë gjë të gjithëve.

Gjithmonë me Zotin

Profeti i nderuar i Islamit (Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qafshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) që në vogëlinë e tij mendonte rreth Zotit dhe fliste me të. Kur ishte 4 vjeç dhe jetonte në shkretëtirë pranë dadas së tij Halimes (nëna e qumështit), një ditë kërkoi prej saj që të shkonte me vëllezërit e tij për të shëtitur. Halimja e veshi dhe e bëri gati. Halimja, pasi e bëri gati, mendoi me vetë se mos humbiste në shkretëtirë... Kështu, nga merakui i vari një hajmali në qafë me qëllim që ta ruante nga e keqja. Ajo mendonte se këto hajmali mund ta ruanin atë (Profetin). Muhamedi (Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qafshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) e hoqi nga qafa hajmalinë e i tha Halimes: - Nuk është nevoja për këto hajmali, nënë e dashur! Zoti im është gjithmonë me mua dhe kujdeset për mua.

Profeti i të mirave

Njerëzit në kohën e Profetit bënin vepra të këqija. P.sh., me duart e tyre ndërtonin idhuj dhe i vendosnin brenda në Qabe. Ata mendonin se idhujt janë zotë dhe mund t'i ndihmonin njerëzit. Të kishe vajzë e dinin si gjynah dhe vajzat e vogla i varrosnin të gjalla. Për arsye më të vogël luftonin dhe vritnin njëri-tjetrin. Vidhnin, vrisnin, mundonin njëri-tjetrin dhe shumë punë të tjera të turpshme.



Zoti e dërgoi Profetin Muhamed (Paqja dhe bekimet e All'llahut qafshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) që t'u mësonte atyre punë të mira; t'u thoshte atyre se idhujt të cilët i ndërtanin me duart e tyre nuk kishin asnjë lloj fuqie e që nuk mund t'i ndihmonin ata; t'u mësonin atyre se të kishe vajzë nuk kishte asnjë ndryshim me djalin; të kërkonte prej tyre që të ishin të mëshirshëm ndaj njëri-tjetrit; të mos luftonin e të mos vidhnin njëri-tjetrin. Profeti u dërgua që t'u mësonte të mirat njerëzve e t'i inkurajonte në kryerjen e punëve të mira.

Feja e fundit

Kishte ardhur feja e fundit, Profeti i fundit dhe Libri i fundit. Feja islame, me Kur'anin dhe përpjekjet e Profetit që ishte shembulli i moralit, filloi rrugën e saj. Profeti kishte përpara një detyrë e një rrugë të vështirë. Njerëzit nuk e pranonin me lehtësi fenë e re. Mirëpo, kjo ishte një detyrë nga ana e Zotit dhe ai, me kalimin e viteve bëri që feja islame të mbërrinte tek të gjithë njerëzit. Sot, jo pak, por me miliarda njerëz nëpër botë jetojnë dhe vënë në jetë detyrat dhe rregullat që solli Profeti me fenë islame.



